



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.177 Akti

Nr. 261 Vendimi

Tiranë, më 16.6.2020

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 16.6.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Blerim Tominaj**, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar me prokurë nga av. Adriatik Cama.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1 998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Blerim Tominaj, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 17.9.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.9.2018 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatini. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Në datën 9.3.2020 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ.

Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme (në vijim PP).

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për pasuritë e trashëguara nga babai;
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar**<sup>2</sup> ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2018.

<sup>2</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 30.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. \*, datë 8.1.2019, të KDZH-së.

**Këshilli i Lartë i Prokurorisë**<sup>1</sup> ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 6. 3.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Blerim Tominaj, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor, z. Blerim Tominaj i janë garantuar të drejtat, si: të njoftohet për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 9.3.2020, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dhanë 10 ditë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj. Subjekti, kërkoi t'i shtyhej afati i depozitimit të prapësimeve dhe provave për shkak të situatës së pandemisë Covid-19. Me njoftimin e datës 23.4.2020, trupi gjykues i ka dhënë subjektit edhe 5 ditë shtesë për dërgimin e shpjegimeve dhe/ose provave në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht. Ky afat filloi të nesërmen e pezullimit të afateve procedurale të përcaktuara në aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19", miratuar me ligjin nr. 30/2020.

Z. Blerim Tominaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 5.6.2020. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit në datën 11.6.2020 ka depozituar një kërkesë për rihapjen e hetimit dhe vlerësimin për 2 kriteret e tjera, atë të figurës dhe vlerësimin profesional. Komisioni, pasi e mori në shqyrtim, vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me arsyetimin se provat e grumbulluara deri në atë moment kishin nivelin e provueshmërisë, e parashikuar kjo në pikën 2, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Trupi gjykues ka argumentuar se në çdo rast, procesi i rivlerësimit, në bazë të ligjit, fillon njëkohësisht për të tria kriteret e vlerësimit. Komisioni vlerësoi se provat e

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2019, dërgohet raporti i KLP-së.

administruara deri në atë fazë të procesit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kishin arritur nivelin e provueshmërisë dhe ishin të mjaftueshme për përfundimin e procesit administrativ.

Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 9.6.2020. Seanca dëgjimore u zhvillua në datat 12.6.2020, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit personalisht në seancën dëgjimore, por u përfaqësua nga përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme nr. \*\*\*, datë 11.6.2020, nga z. Adriatik Cama, i cili shprehu opinionin në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit paraqiti një kërkesë me shkrim për përjashtimin e trupit gjykues, i cili u tërhoq në mënyrë që një tjetër trup gjykues të shqyrtojë kërkesën e depozituar nga përfaqësuesi i subjektit, duke e njoftuar subjektin për vijimin e seancës dëgjimore në po të njëjtën ditë, në orën 15:00.

Komisioni, me vendimin e trupit të posaçëm, të caktuar për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim të trupit gjykues, të mbledhur në datën 12.6.2020, ora 14:30, nuk ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtim të trupit gjykues.

Në përfundim, në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi me prokurë nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit, z. Blerim Tominaj, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Blerim Tominaj ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit.

Në deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 të datës 27.1.2017, subjekti ka deklaruar pasuritë, si vijon:

### **1. Apartament<sup>1</sup> me sip. 164 m<sup>2</sup>, Rr. “F.K”, Tiranë, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Vlera: 2.000.000 lekë.**

Burimi i krijimit:       përfituar nga kursimet familjare.

Deklarimi në DPV:     nuk është deklaruar burimi i krijimit.

---

<sup>1</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/2) kontratë shitje apartamenti nr. \*\*\*, datë 2.2.2007, me palë shitëse znj. E. P dhe dhënë pëlqimi z. Sh. P dhe palë blerëse z. Blerim Tominaj; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 28.12.2000, ku znj. E. P blen nga shoqëria “K.D.K.” sh.p.k. apartamentin me sip. 1641712, plus planimetri.

Mënyra e fitimit: subjekti deklaron se është blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 2.2.2007.

### **1.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**ZVRPP-ja Tiranë**<sup>1</sup> nuk ka konfirmuar këtë pasuri në pronësi të subjektit.

**OSHEE-ja**<sup>2</sup> nuk ka konfirmuar asnjë kontratë furnizimi regjistruar në emër të subjektit dhe personave të tjerë të lidhur për këtë pasuri të deklaruar prej tij.

**UKT-ja**<sup>3</sup> nuk ka konfirmuar asnjë kontratë furnizimi të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të tjerë të lidhur për këtë pasuri të deklaruar prej tij.

### **1.2 Në lidhje me burimin e krijimit**

Subjekti, në DPV-në e parë në vitin 2003, ka deklaruar si adresë banimi këtë pasuri, me përshkrimin “apartament i motrës”. Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti me kontratën nr. \*\*\*, datë 2.2.2007, në shumën 2.000.000 lekë (pa saktësuar burimin e krijimit).

Pasi është pyetur nga Komisioni për burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar<sup>4</sup> se: “...e gjithë vlera e detyrimit prej 2.000.000 lekësh për blerjen e apartamentit rrjedh nga:

1. Vlera 1.000.000 lekë nga shitja e apartamentit në rrugën ‘D. B’ (ka rënë dakord me bashkëshorten që nga vlera totale e shitjes së kësaj pasurie 1.900.000 lekë t’i jepej si kompensim babait të tij në shumën 900.000 lekë, si kontribut për blerjen e apartamentit dhe diferencën, të cilën ia kanë kompensuar babait do ta vinim nga kursimet e përbashkëta);

2. Vlera 1.000.000 lekë nga kursimet nga puna si prokuror nga viti 1993 dhe bashkëshortes si punonjëse e Bashkisë Tiranë prej vitit 1994”.

Pas kërkesës së Komisionit, ILDKPKI-ja ka depozituar procesverbalët<sup>5</sup> e mbajtur nga ky institucion për subjektin e rivlerësimit në vite, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka saktësuar deklaratimet e tij periodike. Në lidhje me DPV-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar se ka disponuar:

- një depozitë bankare në shumën 12.000 euro, e cila është përdorur për blerjen e apartamentit;
- 300.000 lekë *cash*, deklaruar në vitin 2003;
- 600.000 lekë kursime nga viti 2006.

Nga verifikimi i të dhënave bankare ka rezultuar se depozita bankare është tërhequr nga banka në datën 23.3.2007, ndërkohë që kontrata e shitblerjes së apartamentit mban datën 2.2.2007, sipas së cilës citohet se shuma e blerjes së apartamentit prej 2.000.000 lekësh është paguar e plotë jashtë zyrës noteriale.

Komisioni ka vlerësuar se bazuar në të dhënat bankare, kjo depozitë nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi.

### **1.3 Në lidhje me shpenzimet e mobilimit të kësaj pasurie**

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. K \*\*\* prot., datë 16.1.2019.

<sup>4</sup> Në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019.

<sup>5</sup> Ardhur me shkresën e ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2019.

Subjekti ka shpjeguar<sup>1</sup> se: “... çdo pajisje dhe mobilim i banesës së vjetër të rruga ‘D. B’ ka kaluar në apartamentin e ri, duke u plotësuar më pas, vetëm me një dhomë të përdorur gjumi për prindërit e tij, si dhe një ambient studimi për vajzën, pra, një krevat tek dhe një tavolinë së bashku me aksesoret përkatës, ambiente të cilat si prindërit ashtu dhe vajza nuk i dispononin në hapësirën tek apartamenti i vjetër. Gjatë viteve janë bërë përmirësime të vogla për të cilat nuk ka fatura blerjeje.

Rregullime dhe ndryshime në apartamentin në fjalë janë kryer në vitin 2017, për të cilat dhe ka dhënë sqarimet e rastit, në përgjigjet e pyetjeve të para dhe kapin vlerën e rreth 2.200.000 lekëve dhe për vitin 2018 në vlerën e 1.400.000 lekëve...”.

Komisioni ka reflektuar në analizë financiare shpenzimet e mobilimit sipas deklarimeve të subjektit.

#### **1.4 Analiza e fakteve**

Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se këtë apartament subjekti e ka blerë nga e motra, znj. E.P. Ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shitëses E.P është nënshkruar një kontratë shitblerjeje pasurie me nr. \*\*\*, datë 2.2.2007, sipas të cilës shitësi i shet blerësit një apartament me sip. 164 m<sup>2</sup>, në çmimin 2.000.000 lekë, shumë e cila sipas deklaramit të palëve, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Në dosjen e subjektit rezulton kontrata e shitblerjes për pasurinë apartament me sip. 164 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, datë 28.2.2000, me shitës shoqërinë “K.D.K.” sh.p.k., dhe blerës znj. E. P, sipas së cilës znj. E. P e ka blerë fillimisht këtë apartament në shumën 2.600.000 lekë.

Pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar<sup>2</sup> se në këtë pasuri: “ka banuar që në datën 16.10.2000. Ky apartament ishte prenotuar nga motra e tij bashkë me 3 apartamente të tjerë, me qëllim që familja e motrës dhe familja e subjektit të ishin afër. Subjekti ka shpjeguar se në marrëveshje me motrën e tij, kishin rënë dakord që këtë apartament do ta paguante me vlerën e shitjes së apartamentit, ku subjekti banonte paraprakisht, te pallati i prokurorisë në Rr. ‘D. B’”.

Referuar çmimit të referencës në vitin 2007<sup>3</sup>, sipas kontratës së shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 2.2.2007, çmimi i tregut të lirë sipas EKB-së në vitin 2007 ka qenë në vlerën 97.000 lekë/m<sup>2</sup>, sipas përlllogaritjeve vlera e këtij apartamenti duhet të ishte në shumën rreth 15.900.000 lekë. Kur është pyetur në lidhje me vlerën e tregut të apartamentit, subjekti ka shpjeguar se nuk ka asnjë ide sa ka qenë dhe sa është vlere e këtij apartamenti as në kohën kur e bleu dhe as tani. Ndryshimi i vendbanimit është bërë me insistimin e motrës së tij, duke e siguruar se për blerjen e këtij apartamenti do të paguante vetëm vlerën me të cilën do të shiste apartamentin në Rr. “D. B”<sup>4</sup>.

Komisioni, sa më sipër ka konstatuar se çmimi i blerjes (2.000.000 lekë), krahasuar me koston e EKB-së së vitit 2007, duket disa herë më i ulët.

<sup>1</sup> Përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019.

<sup>2</sup> Në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019.

<sup>3</sup> Udhëzim nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k”, për vitin 2007”. Çmimi i tregut të lirë sipas EKB-së në vitin 2007 ka qenë 97.000 leke/m<sup>2</sup>.

<sup>4</sup> Referuar akteve të depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 30.10.2019, subjekti ka depozituar një vërtetim, lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave, sipas të cilit vërtetohet se për blerjen e apartamentit në Rr. “D. B”, subjekti ka paguar shumën 913.453 lekë, shlyer në datën 27.2.1995.

## 1.5 Analiza financiare

Në analizën financiare për periudhën 2003 – 2.2.2007, u përfshinë:

- i. të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten;
- ii. të ardhurat nga interesat bankare të depozitës në “C. B”, verifikuar në lëvizjet e llogarive;
- iii. shpenzimet e jetesës u pasqyruan sipas metodologjisë bazuar te INSTAT-i, të administruar zyrtarisht nga ILDKPKI-ja për familjen e subjektit dhe prindërit;
- iv. shpenzimet për studimet e vajzës në gjimnazin T – O, në mungesë të deklaramit nga subjekti dhe paraqitjes së dokumentacionit janë marrë në shumën 3.350 euro/vit.
- v. shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht, lëvizjet hyrje – dalje, nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaramet e subjektit. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë, vendimi nr.11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe deklaramet e subjektit;
- vi. Në analizë u përfshi gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare, si edhe gjendja *cash*, e deklaruar në deklaramet e interesave pasurore private/vjetore.

Nga analiza financiare, subjekti rezultoi me balancë negative për vitet 2005 dhe 2006, që do të thotë se nuk justifikoi me burime të ligjshme kursimet *cash* të deklaruara në DPV-të.

Nga dokumenti i administruar nga “C. B” rezultoi se subjekti ka depozituar shumën prej 12.000 euro, në datën 21.3.2006, shumë e cila është tërhequr vetëm më 23.3.2007.

Në kontratën e shitblerjes, lidhur përpara noterit datë 2.2.2007, citohet se pagesa për blerjen e apartamentit është kryer e plotë, si rrjedhim nuk mund të ketë shërbyer si burim depozita në “C. B”.

Komisioni kreu analizën financiare deri në datën 2.2.2007 për të vlerësuar mundësinë e subjektit për kursim me burime të ligjshme sipas tabelës vijuese:

	2003	2004	2005	2006	02/02/2007
<b>PASURI</b>	0	0	371 223	629 765	2 017 324
Apartament ne Rr. Elbasanit 164 m2 blere nga motra ne 2007					2 000 000
<b>DIFERENCE LIKUIDITETI (DIF. LIK. - LIKUIDITETE VITI PARAA</b>	0	0	371 223	629 765	17 324
<b>LIKUIDITETE (FUND VITI Dok.)</b>	<b>1 200 000</b>	<b>1 200 000</b>	<b>1 571 223</b>	<b>2 200 988</b>	<b>2 218 312</b>
<b>DETYRIME</b>	0	0	0	0	0
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	0	0	371 223	629 765	2 017 324
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>960 730</b>	<b>1 236 119</b>	<b>1 186 850</b>	<b>1 261 958</b>	<b>125 854</b>
Te ardhura SR	646 740	863 815	819 838	828 627	91 699
Te ardhura b/shortja	313 990	372 304	367 012	405 490	34 155
Te ardhura nga interesat e depozites n Credins				27 841	
<b>SHPENZIME</b>	<b>469 820</b>	<b>894 399</b>	<b>1 245 038</b>	<b>1 256 603</b>	<b>56 422</b>
Shpenzime jetese	469 820	469 820	547 785	547 785	45 540
Shpenzime udhetimi	0	0	286 744	294 413	10 882
Shpenzimet e arsimimit ne Turgut Ozal Vajza 2004-2008		424 579	410 509	414 405	
<b>LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT</b>	<b>1 200 000</b>	<b>1 200 000</b>	<b>1 571 223</b>	<b>2 200 988</b>	<b>2 218 312</b>
1. Cash i deklaruar (DPV)	1 200 000	1 200 000	1 500 000	600 000	600 000
2. Depozite Credins				1 512 269	1 512 269
3. Banka Procredit Lejla Tominaj b/sh			1 009	287	912
4. Credins Bank, Blerim Tominaj					
5. RBAL Blerim Tominaj			70 214	88 432	105 131
<b>Rezultati financiar</b>	<b>490 910</b>	<b>341 720</b>	<b>-429 411</b>	<b>-624 411</b>	<b>-1 947 892</b>

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të paguar shumën e plotë në datën 2.2.2007, në shumën totale prej - **3.001.713 lekësh**.



## 1.6 Në lidhje me këtë pasuri u konstatua:

- Mospërputhje në deklaratimet e subjektit për burimin e krijimit të kësaj pasurie:
  - në deklaratën “Vetting” janë deklaruar si burim të ardhurat nga kursimet;
  - në procesverbalet e mbajtur në ILDKPKI është deklaruar se është përdorur depozita bankare në shumën 12.000 euro, + 300.000 lekë *cash*, deklaruar në vitin 2003 + 600.000 lekë kursime nga vitit 2006.
  - i pyetur nga Komisioni për burimin e kësaj pasurie, subjekti deklaroi: 1.000.000 lekë nga shitja e apartamentit në Rr. “D. B” dhe vlera 1.000.000 lekë, nga kursimet nga puna si prokuror nga viti 1993 dhe bashkëshortes si punonjëse e Bashkisë Tiranë prej vitit 1994.
- Për këtë pasuri, çmimi i blerjes në vlerën 2 milionë lekë duket joreal dhe shumë i ulët, pasi krahasuar me çmimet e referencës sipas EKB-së në vitin 2007 kjo pasuri do të kushtonte afërsisht 15.9 milionë lekë.
- Çmimi i blerjes së pasurisë nga subjekti është më i ulët nga sa e ka blerë shitësi (motra).
- Subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 3.001.713 lekë.

**Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.**

## 1.7 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit me prapësimet e datës 5.6.2020 ka pretenduar se:

i. Mospërputhja e burimit të krijimit të kësaj pasurie konstatuar nga Komisioni, si “gjetje” nuk është e bazuar dhe tregon një qëndrim subjektiv dhe paragjykses të çështjes dhe vlerësimit të tij, duke cenuar të drejtën për një proces të rregullt e të drejtë vlerësimi.

Subjekti ka argumentuar se ky konstatim nuk qëndron pasi nuk bëhet fjalë për mospërputhje, por ka vetëm detajime të përgjigjes si pasojë e pyetjeve drejtuar nga Komisioni gjatë hetimit. Të gjitha burimet e përdorura, si depozita bankare, si shuma që është përfitur nga shitja e apartamentit në “D. B”, të cilat nuk janë përdorur dhe janë lënë mënjanë, përbëjnë kursime, të cilat kanë shërbyer si burime për këtë pasuri.

ii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit për çmimin e shitblerjes së apartamentit si joreal, referuar kjo me koston e EKB-së, për vitin 2007, subjekti ka shpjeguar se në këtë apartament ka filluar të banojë që në vitin 2000, mbështetur kjo edhe në kontratën e furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, të cilën e ka depozituar edhe në Komision. Duke marrë në konsideratë çmimet e apartamenteve në vitin 2000, vlera e apartamentit të blerë prej tij nuk është joreal. Kostoja sipas EKB-së, ku është mbështetur Komisioni është kosto e vitit 2007 dhe referenca në këtë vit, pa pasur parasysh provat e sjellura prej tij, që provojnë se subjekti ka jetuar që në vitin 2000 në atë apartament, e bëjnë qëndrimin e Komisionit të paragjykuar ndaj çështjes së tij. Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka depozituar dy kontrata të tjera shitjeje mes shtetasve Sh.P dhe T. N nr. \*\*\*, datë 19.12.2002 dhe kontratën e shitblerjes mes shtetasve Sh. P dhe R.C nr. \*\*\*, të po asaj date. Bëhet fjalë për dy nga apartamentet që çifti P kishte prenotuar sipas kontratave të sipërmarrjes, që i ka vënë në dispozicion dhe këto

apartamente ndodhen vetëm dy kate larg apartamentit ku banon subjekti, i cili ka argumentuar se çmimi i shitjes është i njëjtë për m<sup>2</sup> me atë që i është shitur apartamenti dhe atij.

iii. Në lidhje me faktin se subjekti e ka blerë këtë apartament në vlerën 600.000 lekë më lirë sesa e ka blerë shitësi i tij (motra), ka argumentuar se Komisioni në vlerësim të fakteve duhet të marrë në konsideratë marrëdhëniet familjare, ku nuk është e pazakontë që motër e vëlla dhe anasjellas të ndihmojnë njëri-tjetrin financiarisht. Ndihma që është dhënë në këtë rast nga motra, për banesën ku do të banonin edhe prindërit e saj, pasi prindërit banonin me subjektin, është në vlerën 600.000 lekë (diferenca ndërmjet çmimit të blerjes së apartamentit nga motra fillimisht dhe çmimit që ia ka shitur subjektit). Ndihma tjetër që motra i ka dhënë është lehtësia në pagesën e kësaj vlere, etj.

Subjekti argumentoi se çmimi i referencës që ka përdorur Komisioni nuk është çmimi përfundimtar i një marrëdhënieje kontraktore. Kodi Civil, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, mbizotëron mbi çdo ligj apo akt nënligjor, duke përcaktuar parimin bazë të kontratave: lirinë kontraktore.

iv. Në lidhje me balancat negative që rezultuan në analizë, subjekti argumentoi se fakti që pagesa e detyrimeve për shlyerjen e çmimit për blerjen e apartamentit, cituar në “Kontratën e lidhur përpara noterit në datën 2.2.2007”, është vendosur në akt për të mos pasur probleme në regjistrimin e saj në ZVRPP dhe pasi palët, motër e vëlla, e konsideronin të ezauruar çështjen e kontratës. Në nenet e kontratës në fjalë është përcaktuar se “palët janë likuiduar jashtë kësaj zyre noteriale”. Ky është një deklaram që në ato vite e më tej vendosej nga noteri për të hequr përgjegjësinë e tij për transaksionin e pagesës. Subjekti argumenton se nuk kishin nevojë për kontratën për të përmbushur detyrimet ndaj njeri-tjetrit. Për këtë arsye, argumenti i Komisionit se depozita në “C. B” nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e apartamentin nuk qëndron, pasi interpretimi literal apo skolasik i këtij neni në një marrëdhënie si ajo e subjektit me motrën tregon që Komisioni nuk ka mbajtur parasysh kontekstin e përgjithshëm të marrëdhënies, duke e trajtuar si një numër dosje e për më tepër të paragjykuar e të pa mbajtur parasysh as vitet e tij të karrierës profesionale dhe as vlerësimin maksimal që ka pasur çdo vit.

Gjithashtu, subjekti ka kundërshtuar faktin se Komisioni në analizën financiare të kryer, ka ngarkuar balancën financiare për vitet 2004 – 2008, me shpenzimet e shkollimit të vajzës në kolegjin “T.O”. Subjekti argumentoi se ka bërë me dije se nuk disponon asnjë lloj dokumentacioni për këto shpenzime, ashtu sikurse edhe Komisioni nuk arriti të administrojë as edhe një fakt që këto shpenzime janë në shifrat e përfshira në analizë. Vajza e subjektit gjatë gjithë viteve ka përfituar bursë, e cila ka qenë praktikë në sistemin e kolegjit në fjalë.

## **1.8 Analiza ligjore**

i. Në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve të subjektit për burimin e krijimit të pasurisë, referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe krahasimit të tyre me deklaratat periodike vjetore, mbështetur dhe në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se z. Blerim Tominaj nuk ka qenë konsistent me deklaratimet e tij në lidhje me burimin e krijimit. Subjekti është pyetur nga Komisioni për të konfirmuar burimin dhe rezultoi se ka dhënë versione të ndryshme për burimin e krijimit të kësaj pasurie apo kursimet që kanë shërbyer për krijimin e saj. Referuar akteve, por edhe hetimit të kryer, nuk mundet që subjekti të ketë përdorur si burim krijimi depozitën bankare, e cila është tërhequr nga banka në datën 23.3.2007, ndërkohë që kontrata e shitblerjes së apartamentit është e datës 2.2.2007, sipas së

cilës citohet se shuma e blerjes së apartamentit prej 2.000.000 lekësh është paguar e plotë jashtë zyrës noteriale. Komisioni, me gjithë shpjegimet e dhëna nga subjekti, ka mbështetur arsyetimin në prova shkresore si kontrata e shitblerjes hartuar para noterit, e cila ka fuqi të plotë provuese. Shpjegimet e subjektit, nëse bien ndesh me aktet ligjore, sikurse shprehet në lidhje me mospërputhjen e datës së kontratës së shitblerjes me tërheqjen e shumave të depozitës bankare, nuk mund të shërbejnë si argumente bindëse për Komisionin dhe nëse në mes janë marrëdhëniet familjare motër e vëlla.

ii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit për çmimin e shitblerjes së apartamentit si joreal, referuar kjo koston e EKB-së, për vitin 2007, Komisioni vlerësoi se edhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit se ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2000, çmimi i referencës sipas EKB-së për vitin 2000<sup>1</sup>, është më i lartë se çmimi i paguar nga subjekti. Kostoja e EKB-së është një referencë që përdor Komisioni për të krijuar bindjen nëse çmimet e paguara nga subjekti përfaqësohen me realitetin kur ndodh veprimi juridik, duke marrë në vlerësim edhe vullnetin kontraktor të palëve. Në këtë rast, nëse krahasojmë çmimet sipas koston e EKB-së me çmimin që ka paguar subjekti, rezulton një diferencë shumë e madhe, fakt që i bën shpjegimet e subjektit jo të besueshme. Kontratat e ngjashme, të depozituara për të treguar se çmimi i blerjes për m<sup>2</sup> nga subjekti është i përafërt me ato të kontratave që ka depozituar, rezultojnë se janë kopje të akteve, të palexueshme dhe nuk dallohet çmimi i shitjes së tyre. Në çdo rast, argumenti i përdorur nga subjekti se e ka blerë këtë pasuri sipas vlerës që ka pasur në atë periudhë nuk mund të pranohet nga Komisioni, duke marrë në konsideratë që subjekti e ka blerë këtë apartament më lirë sesa e ka blerë motra e tij.

iii. Në lidhje me shpenzimet e shkollimit, referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti kishte detyrimin ligjor të shpjegonte bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Në këtë frymë, subjekti nuk mundi të provojë që nuk ka shpenzuar apo që ka pasur shpenzime minimale për studimet e vajzës në kolegji dhe se është trajtuar me bursë. Subjekti kishte barrën e provës për të bindur Komisionin për pretendimet e tij, megjithatë, në mungesë të provave të kundërta, trupi gjyqësor vlerësoi të mos përfshijë shpenzimet e shkollimit për vajzën e subjektit në kolegjin turk, në analizën financiare të kryer për vitet 2004 – 2008.

Analiza financiare pas prapësimeve paraqitet, si vijon:

---

<sup>1</sup> Referuar të dhënave nga Enti Kombëtar i Banesave ([www.ekb.gov.al](http://www.ekb.gov.al)).

Pershkrimi	2003	2004	2005	2006	2.2.2007
<b>Pasuri</b>	<b>500 000</b>	<b>0</b>	<b>371 223</b>	<b>629 765</b>	<b>2 017 324</b>
Autoveture Benz 250, TR 4757 F	500 000				
Apartament ne Rr. Elbasanit 164 m2					2 000 000
<b>Diference likuiditetesh</b>	-	-	371 223	629 765	17 324
<b>Detyrime</b>	-	-	-	-	-
<b>Pasuri neto</b>	<b>500 000</b>	<b>0</b>	<b>371 223</b>	<b>629 765</b>	<b>2 017 324</b>
<b>Te ardhura</b>	<b>960 730</b>	<b>1 236 119</b>	<b>1 186 850</b>	<b>1 261 958</b>	<b>125 854</b>
Te ardhura te Subjektit	646 740	863 815	819 838	828 627	91 699
Te ardhura te bashkeshortes	313 990	372 304	367 012	405 490	34 155
Te ardhura nga interesat e depozites n Credins				27 841	0
<b>Shpenzime</b>	<b>469 820</b>	<b>469 820</b>	<b>802 668</b>	<b>821 787</b>	<b>56 422</b>
Shpenzime jetese	469 820	469 820	547 785	547 785	45 540
Shpenzime udhetimi	-	-	254 883	274 002	10 882
<b>Likuiditete ne fund te vitit</b>	<b>1 200 000</b>	<b>1 200 000</b>	<b>1 571 223</b>	<b>2 200 988</b>	<b>2 218 312</b>
Gjendje Cash ne fund te vitit	1 200 000	1 200 000	1 500 000	600 000	600 000
Depozite ne Credins Bank				1 512 269	1 512 269
Llogari e b/shortes ne Procredit Bank			1 009	287	912
Llogari e Subjektit ne RBAL			70 214	88 432	105 131
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-9 090</b>	<b>766 299</b>	<b>12 959</b>	<b>-189 595</b>	<b>-1 947 892</b>

### Përfundimisht, në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues ka konstatuar:

- Mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 2.146.577 lekë.
- Mospërputhje deklarimesh të subjektit për burimin e krijimit të kësaj pasurie.
- Çmimi i blerjes së pasurisë është joreal dhe shumë i ulët krahasuar me çmimet e referencës sipas EKB-së;
- Çmimi i blerjes së pasurisë nga subjekti është më i ulët nga sa e ka blerë shitësi (motra).

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

### 2. Pasuria “lokal” , me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup>, Rr. “S. F”<sup>1</sup>, Tiranë. Pjesa takuese: 100 %.

Vlera e deklaruar: 140.000 euro.

Burimi i krijimit: përfituar nga kursimet familjare dhe deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.7.2010.

Deklarimi në DPV: nuk është deklaruar burimi i krijimit në DPV-në e vitit 2011.

Mënyra e fitimit: subjekti ka deklaruar se pasuria është blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.6.2011.

<sup>1</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë nr. \*\*\*, datë 16.6.2011, ku z. Blerim Tominaj ble njësi me sip. 75 m<sup>2</sup>, në Rr. “S. F”. Shuma që përfaqëson çmimin total të shitjes është caktuar nga të dy palët me vullnetin e tyre të lirë jashtë zyrës noteriale në shumën 140.000 euro.
- Certifikatë pronësie datë 24.6.2011, në emër të z. Blerim Tominaj për njësi me sip. 75 m<sup>2</sup>, në Rr. “S. F” Tiranë.
- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.7.2010, ndërmjet shtetasve Sh. P dhe Blerim Tominaj, ku ky i fundit merr hua nga z. Sh P shumën prej 100.000 euro, pa interes. Huaja do të shlyhet brenda një periudhe 10-vjeçare, duke filluar nga data e nënshkrimit të deklaratës. Shlyerja mund të bëhet e plotë në fund të periudhës ose me këste sipas mundësisë të z. Blerim Tominaj.
- Kontratë nr. \*\*\*, datë 31.10.2009, ndërmjet shtetasit Sh. P dhe shoqërisë “O.E.S. D” sh.p.k., ku sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 12.6.2008, z. Sh. P ka porositur në godinën që ka përfunduar sipërmarrësi Sh. K, në bazë të lejes së ndërtimit të lëshuar nga Bashkia Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.8.2003, në Blv. “Bajram Curri” midis të tjerave, edhe lokal me sip. 35 m<sup>2</sup>, me vlerë 45.000 euro; ambient me sip. 341 m<sup>2</sup> me vlerë 170.500 euro dhe ambient me sip. 341 m<sup>2</sup> me vlerë 170.500 euro, të cilat ia shet shoqërisë “O.E.S. D” sh.p.k. kundrejt shumës 550.000 euro, nga të cilat 55.000 euro janë paguar me nënshkrimin e kontratës.

## 2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

**ZQRPP-ja**<sup>1</sup> konfirmon pasurinë nr. \*\*\*, me sip. 75 m<sup>2</sup>, vol. \*\*, f. \*\*, z. k. \*\*\*, lloji “njësi”, regjistruar në emër të z. Blerim Tominaj.

**OSHEE-ja**<sup>2</sup> nuk konfirmoi asnjë kontratë furnizimi regjistruar në emër të subjektit dhe personave të tjerë të lidhur për këtë pasuri.

**UKT-ja**<sup>3</sup> informoi se në emër të z. Blerim Tominaj, referuar sistemit të menaxhimit të informacionit, identifikohet një kontratë me adresë: Rr. “S. F” Tiranë. Kontrata është me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve privatë, me detyrime të likuiduara deri në nëntor të vitit 2018.

**Bashkia Tiranë**<sup>4</sup> konfirmoi se z. Blerim Tominaj ka të regjistruar në programin informatik pronë (dyqan) me sip. 75m<sup>2</sup>, nr. pasurie (\*\*\*), z. k. \*\*\* në adresën: Rr. “S. F”, p. \*, k. \*, me status aktiv, data e fillimit të detyrimeve 16.6.2011.

## 2.2 Burimi i krijimit

Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *“Hua për blerje apartamenti në shumën 100.000 euro. Kontrata nr. \*\*\*, datë 2.7.2010, pa interes për 10 vjet. Huadhënësi Sh. P”*.

Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar te kapitulli i ndryshimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme: *“Lokal në Rr. ‘S. F’, sip. 75 m<sup>2</sup>, blerë nga shtetasi A. B me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.6.2011, notere L. K, në shumën 140.000 euro”*. Nuk ka deklaruar burim krijimi.

Në rubrikën “detyrime financiare” ndaj personave fizikë e juridikë, subjekti ka deklaruar: *“Hua për blerje objekt – lokal në Rr. ‘S. F’. Deklaratë dore me shtetasin E. S, datë 7.6.2011, 8.000 euro, pa afat shlyerje dhe pa interesa”*.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” si burim krijimi për këtë pasuri huan në shumën 100.000 euro, marrë z. Sh. P dhe kursime familjare. Në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar huan e marrë nga z. E. S, si një nga burimet e krijimit të pasurisë lokal. ka deklaruar huanë e marrë nga z. E.S, si një nga burimet e krijimit të pasurisë lokal. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar burimin e krijimit në momentin e krijimit të pasurisë siç parashikohet në pikën 7, të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së.

Komisioni i kërkoi subjektit që të saktësojë kursimet familjare dhe periudhën që i përkasin këto kursime. Subjekti ka shpjeguar<sup>5</sup> se:

*“100.000 euro i janë marrë borxh pa interes kumatit Sh. P;*

*8.000 euro i janë marrë borxh pa interes mikut të familjes, z. E.S, pronar i firmës ‘G. C’ në Durrës; 32.000 euro (konvertuar në lekë) nga kursimet familjare të viteve 2008 – 2011. Shumat respektive sipas viteve:*

*2008 - 1.500.000 lekë;*

<sup>1</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së. ZQRPP-ja, në shkresën nr.\*\*\* prot., datë 4.3.2019, drejtuar Komisionit nuk ka konfirmuar pasuri në pronësi të subjektit Blerim Tominaj.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. K \*\*\* prot., datë 16.1.2019.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 8.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>5</sup>Në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019.

2009 - 1.355.000 lekë;

2010-1.000.000lekë.

### 2.3 Analiza e fakteve

Ndërmjet subjektit në cilësinë e blerësit dhe shitësit A. B, është nënshkruar një kontratë shitjeje me nr. \*\*\*, datë 16.6.2011, ku z. Blerim Tominaj ka blerë një njësi me sip. 75 m<sup>2</sup>, në Rr. “S. F”. Shuma që përfaqëson çmimin total të shitjes është caktuar nga të dy palët me vullnetin e tyre të lirë jashtë zyrës noteriale në shumën 140.000 euro.

Në dosje rezulton një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.7.2010, ndërmjet shtetasve Sh. P dhe Blerim Tominaj, sipas së cilës z. Sh. P i jep hua subjektit shumën prej 100.000 euro, pa interes. Huaja do të shlyhet brenda një periudhe 10-vjeçare, duke filluar nga data e nënshkrimit të deklaratës. Shlyerja mund të bëhet e plotë në fund të periudhës ose me këste sipas mundësive të huamarrësit Blerim Tominaj.

Deklarata noteriale me huadhënësin Sh. P është e datës 2.7.2010, ndërkohë që pasuria për të cilën u mor kjo kredi është blerë në datën 16.6.2011, gati 1 vit më vonë. Pasi u pyet nga Komisioni se ku i ka mbajtur shumat e marra hua deri në momentin e blerjes së pasurisë, subjekti shpjegoi<sup>1</sup> se: “...shuma totale e huas nuk është mbajtur nga ai, por sipas rastit është paguar nga huadhënësi, kunati Sh. P, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2010 deri në mesin e vitit 2011. Kjo dhe sipas mandatpagesave ku në një pjesë të tyre shënohet edhe pagesa e kryer për apartament”.

Nga verifikimi i akteve rezultoi e aprovuar me dokumentacion që subjekti ka marrë fizikisht këtë hua nga z. Sh. P dhe përveç deklaratës së palëve nuk ka asnjë akt tjetër. Deklarata noteriale është nënshkruar 1 vit përpara se subjekti të nënshkruajë kontratën për blerjen e kësaj pasurie. Në deklaratë citohet se subjekti e ka marrë huan, ndërsa në pyetësor<sup>2</sup> ka shpjeguar që nuk e ka tërhequr atë, por huadhënësi ka bërë pagesat sipas datave në mandate. Gjithashtu, subjekti, në DPV-në e vitit 2010 nuk ka deklaruar asnjë nga pagesat e kryera për blerjen e pasurisë. Nga administrimi i dokumentacionit, rezultoi se në vitin 2010, janë bërë dy pagesa në shumën totale prej 63.000 euro.

Subjekti, për pagesat e kryera shitësit, ka shpjeguar<sup>3</sup> se: “Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, pra, faturat justifikuese po jua bashkëngjis. Nga përlllogaritjet del mungesë një faturë që duhet të jetë bërë nga kunati im dhe që nuk më është dorëzuar”.

Subjekti ka depozituar mandatarkëtimet:

- i. nr. \*, datë 6.6.2011, arkëtuar nga z. B. T, shuma prej 2.900 USD, me përshkrimin “arkëtuar për likuidim apartamenti”;
- ii. nr. \*\*\*, datë 22.7.2011, arkëtuar nga z. Blerim Tominaj, shuma 40.000 euro, me përshkrimin “likuidim lokali te Drejtoria Policisë”;
- iii. nr. \*\*, datë 1.9.2010, arkëtuar nga z. Blerim Tominaj, shuma 50.000 euro, me përshkrimin “arkëtuar për blerje apartamenti”;
- iv. nr. \*\*\*, datë 21.12.2010, arkëtuar nga z. Blerim Tominaj, shuma 13.000 euro, me përshkrimin “likuidim kësti banese”;

<sup>1</sup> Me përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019.

<sup>2</sup> Me pyetësorin e datës 30.10.2019.

<sup>3</sup> Me pyetësorin e datës 30.10.2019.

- v. nr. \*\*, datë 6.6.2011, arkëtuar nga z. B.T, shuma 20.000 euro, me përshkrimin “pagesë kësti për apartament”.

Shuma në total, e likuiduar sipas mandatarkëtimeve, është 125.000 euro.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime<sup>1</sup> subjektit se kur i është bërë pagesa e mbetur shitësit prej 15.000 euro, i cili ka shpjeguar<sup>2</sup> se nuk ka ndonjë datë në lidhje me këtë, por rikonfirmon se këto pagesa janë bërë prej tij dhe kunatit të tij ose edhe nga ai vetëm. Mandati për këtë pagesë mund të disponohet prej kunatit dhe nuk i është vënë në dispozicion ose dhe ndoshta për pakujdesi është humbur. Ai (kunati Sh. P) ndodhet aktualisht për pushime në SHBA.

Nga verifikimi i kartelës së pasurisë rezultoi se kjo pasuri i është shitur subjektit nga z. A. B, në çmimin 140.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes së datës 24.6.2011. Z. A. B e kishte blerë këtë pasuri 9 ditë përpara se t’ia shiste subjektit, sipas kontratës së shitblerjes së datës 13.6.2011, në çmimin 150.000 euro, shoqërisë “P. \*\*” sh.p.k. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për marrëdhënien me z. A. B dhe arsyen që ky person e ka shitur këtë pasuri më lirë sesa e ka blerë.

Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit, shpjegoi se nuk ka qenë në dijeni të një fakti të tillë dhe as të datave që referohen në pyetësin drejtuar nga Komisioni. Subjekti sqaroi se marrëdhënia me z.A.B/shitësin është marrëdhënie kontraktuale, e zakonshme midis një blerësi dhe përfaqësuesit të shoqërisë që do të shiste ambientet. Midis tyre nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë marrëdhënie tjetër as personale dhe as profesionale. Gjatë karrierës profesionale nuk ka ndodhur asnjë rast që z. A. B dhe subjekti të kenë pasur ndonjë konflikt interesi. Me z. A B subjekti shpjegoi se është njohur fillimisht në vitin 2008, në kuadër të zgjidhjes së një çështjeje shitblerje apartamenti të një familjari të tij, siç shpjegohet në vijim.

Mandatpagesat e depozituara nga subjekti për blerjen e pasurisë “Lokal”, janë bërë për llogari të shoqërisë “L-EM” sh.p.k. Kjo pasuri i është shitur subjektit nga z. A. B dhe jo nga personi juridik. Subjekti<sup>3</sup> është pyetur se përse mandatpagesat rezultojnë t’i jenë paguar shoqërisë “LIM-EM” sh.p.k, ndërkohë që shitës ka qenë z. A. B, si individ. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit, ka shpjeguar se: *“Siç edhe kam sqaruar më parë, marrëdhëniet financiare kanë qenë me firmën L-EM dhe personalisht me shtetasin A. B, i cili së bashku me shtetasin Sh. B më kanë ofruar mundësi zgjedhjeje, por nuk ishin në përputhje me kërkesat e tij. Në këto kushte kanë parë dy tre objekte të firmës së tyre dhe me pas dhe të një kontraktori të tyre me të cilin kishin në dijeninë time marrëdhënie kleringu. Dhe pse u dakordësua në fillim, me pas ai ofroi ambiente tejet të papërshtatshme dhe në këto kushte propozimi përfundimtar ishte pasuria e ndodhur në rrugën ‘S. F’ të cilin e pranova”*. Subjekti nuk ka argumentuar bindshëm faktin që pagesat janë bërë në emër të shoqërisë dhe jo në emër të shitësit. Edhe pas shpjegimeve të dhëna prej tij, për Komisionin nuk është e qartë arsyeja pse pagesat rezultojnë në emër të shoqërisë shitëse “L-EM” sh.p.k.

Shoqëria “L – EM”<sup>4</sup> sh.p.k., shpjegoi se ndërmjet z. Blerim Tominaj dhe administratorit të shoqërisë z. A. B është lidhur kontrata e shitjes me nr. \*\*\*, datë 6.6.2011, pranë noteres L. K për shitjen e pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, z. k. \*\*\*, sipas së cilës palët janë likuiduar me

<sup>1</sup> Me pyetësin e datës 7.2.2020.

<sup>2</sup> Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020.

<sup>3</sup> Me pyetësin e datës 7.2.2020.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. \*\* prot., datë 20.2.2020.

njëri-tjetrin dhe pronësia ka kaluar në favor të blerësit Blerim Tominaj. Shoqëria ndërtuese sqaroi se nuk disponon dokumentacion provues për pagesat e kryera, por nuk ka asnjë pretendim lidhur me shitjen.

#### **2.4 Në lidhje me burimet financiare të huadhënësit Sh.P, nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se:**

**QKB-ja<sup>1</sup>** ka informuar, si më poshtë:

- z. Sh. I. P rezulton ortak me 50 % të kapitalit dhe administrator në shoqërinë “F. G” sh.p.k., me NIPT L\*\*\*N. Aktualisht, kjo shoqëri është me status “në likuidim e sipër”;
- z. Sh. I. P rezulton ortak i vetëm dhe administrator në shoqërinë “N” sh.p.k., me NIPT K\*\*\*S. Aktualisht, kjo shoqëri është me status “çregjistruar”.
- z. Sh. I. P rezulton ortak me 40 % të kapitalit dhe administrator në shoqërinë “T” sh.p.k., me NIPT K\*\*\*J.
- z. Sh. I. P rezulton të ketë qenë si zv/kryetar i këshillit mbikëqyrës në shoqërinë “A” sh.a., me NIPT J\*\*\*E, larguar më 1.9.2008;
- z. Sh. I. P i datëlindjes 5.8.1950, figuron i regjistruar si Person Pizik me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.12.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT.
- z. Sh.I.P, i datëlindjes 5.8.1950, figuron i regjistruar si Person Fizik me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.2.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT.

**DPT-ja<sup>2</sup>** informoi se nga verifikimi i të dhënave në sistemin *C@TS* dhe arkivës pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore në Tiranë rezulton se:

- a) Shtetasi Sh. P është administrator i shoqërisë “N” sh.p.k., me NIPT K\*\*\*S, regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në datën 26.5.2008, me aktivitet nxjerrje e mineralit të hekurit, kaluar me status i çregjistruar në datën 9.2.2009.
  - Për periudhën 26.5.2008 - 9.2.2009, shoqëria nuk ka deklaruar të ardhura.
  - Për periudhën 26.5.2008 - 9.2.2009, shoqëria nuk ka deklaruar dhe paguar kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
  - Deri në datën 24.1.2019, shoqëria “N” sh.p.k., me NIPT K\*\*\*S, nuk ka detyrime të papaguara pranë organit tatimor.
  - Shoqëria nuk ka deklaruar në sistem apo depozituar në arkiv pasqyra financiare.
- b) Shtetasi Sh. P është administrator i shoqërisë “F. G” sh.p.k., me NIPT L\*\*\*N, regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në datën 13.8.2010, me aktivitet farmaci tregti me pakicë e artikujve mjekësorë. Kjo shoqëri ka kaluar me status pasiv në datën 12.12.2014.
  - Për periudhën 13.8.2010 -12.12.2014, shoqëria nuk ka deklaruar të ardhura.
  - Për periudhën 13.8.2010 -12.12.2014, shoqëria nuk ka deklaruar dhe paguar kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
  - Deri më 24.1.2019 subjekti “F. G” sh.p.k., me NIPT L\*\*\*N ka detyrime të papaguara pranë organit tatimor shumën 45.000 lekë (bashkëlidhur pasqyra e detyrimeve në kohë reale datë 24.1.2019).

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2019.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019.



- Shoqëria nuk ka deklaruar në sistem apo depozituar në arkiv pasqyra financiare.

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua, subjekti ka deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 18.2.2016 se kjo shumë buron nga të ardhurat si drejtor në shoqërinë “T” sh.p.k., ndërkohë që në përgjigje të pyetësorit subjekti ka sjellë kontrata shitblerje pasurie të paluajtshme dhe 1 vendim gjykate për ndërprerjen e një kontrate qiraje 10-vjeçare, që huadhënësi kishte me një palë tjetër kontraktore.

Subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin karshi huadhënësit Sh. P, si vijon:

- DPV-ja e vitit 2012: shlyer detyrimi prej 8.000 euro për z. E. S, detyrimi 0, deklaruar si detyrim i shlyer në vlerën 3.000 euro dhe nga huaja e z. Sh. P, mbetet vlera 97.000 euro.
- DPV-ja e vitit 2013: shlyer vlera prej 10.000 euro, mbetur vlera 87.000 euro detyrim.
- DPV-ja e vitit 2014: shlyer vlera prej 10.000 euro, mbetur vlera 77.000 euro.
- DPV-ja e vitit 2015: shlyer vlera prej 15.000 euro, mbetur vlera 62.000 euro.
- DPV-ja e vitit 2016: shlyer vlera prej 15.000 euro, mbetur vlera 47.000 euro.
- Deklarata “Vetting” 2017: subjekti deklaroi detyrim në shumën 47.000 euro.

Në lidhje me huan e marrë z. Sh. P, subjekti është shprehur se<sup>1</sup>: “Nuk kam marrë ndonjë dokument formal/ faturë për shlyerjen e detyrimit, kjo dhe për shkak të marrëdhënies që kam me të. Gjithçka është rregulluar në bazë të një tabele të firmosur nga vetë z. Sh.P, e cila disponohet nga palët me të dhënat për shumat e paguara gjatë viteve”. Subjekti u ka bashkëlidhur përgjigjeve një dokument për pagesat sipas viteve ku pasqyrohen pagesat, si dhe rezulton edhe një nënshkrim pas çdo shume. Pagesat, sipas këtij dokumenti, përputhen me deklaratimet e subjektit në DPV për shlyerjen e detyrimeve.

Nga verifikimi i llogarive bankare rezultoi se huadhënësi Sh. P ka transaksione në shuma të konsiderueshme në llogaritë në lekë dhe në valutë. Nga këto transaksione kuptohet se ai ka kryer, ndër vite, biznes dhe se ka gjeneruar të ardhura.

Sidoqoftë, nga dokumentacioni i administruar nga “R. B” rezultoi se z. Sh. P i është *disbursuar* në datën 11.8.2010, kredia në shumën 144.000 euro për blerje apartamenti me interes 7.93 %. Shuma e kredisë i është transferuar në të njëjtën datë shitësit.

Nga dokumentacioni i administruar në lidhje me pagesat e kësteve për dyqanin e blerë, subjekti, në përgjigje të pyetësorëve, shpjegoi se pagesat duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2010 janë kryer nga z. Sh. P. Nisur nga analiza e fakteve, Komisioni ngriti dyshime që kësti i parë në datën 1.9.2010 të jetë paguar nga z. Sh. P, kur vetëm disa javë më parë ky i fundit ka blerë një apartament me kredi. Gjithashtu, tri nga mandatet e administruara rezultojnë të jenë firmosur nga subjekti.

Për të provuar burimin e ligjshëm të huadhënësit Sh.P, subjekti ka depozituar dokumentacion ligjor<sup>2</sup>, ku huadhënësi rezulton se ka pasur mundësi financiare për huan e dhënë subjektit.

<sup>1</sup> Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019.

<sup>2</sup> Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr. \*\*\*, datë 31.10.2009, sipas së cilës shitësi Sh. P, do t'i shesë shoqërisë “O.E.S D” sh.p.k., lokal me sip. 35 m<sup>2</sup>, ambient me sip. 341 m<sup>2</sup> dhe ambient me sip. 341 m<sup>2</sup> në shumën totale prej 550.000 euro;

1. Vendim gjykate me nr. \*\*, datë 25.4.2008, me palë paditëse shtetasit E dhe Sh. P, të paditur shoqërinë “A. A. M” sh.p.k., dhe me objekt “Zgjidhje e kontratës së qirasë, lirim të objektit”. Sipas këtij vendimi, rezulton se z. Sh. P ka dhënë me qira një pasuri të paluajtshme për shoqërinë “A. A. M” sh.p.k., për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga data 7.2.2003, në çmimin 5.000 USD/muaj;

2. ekstrakt historik i shoqërisë “T” sh.p.k., themeluar në datën 1.12.2004, ku z. Sh. P figuron një nga ortakët e shoqërisë;

3. deklaratë dore e datës 7.6.2011, lëshuar nga z. E. S, i cili deklaron se i ka dhënë hua z. Blerim Tominaj shumën prej 8.000 euro, pa interes;

## 2.5 Analiza financiare

Në tabelën si vijon, u analizua mundësia e blerjes së lokalit, ku janë paraqitur të dhënat e administruara nga Komisioni në dosjen e plotë hetimore të subjektit.

**Në lidhje me pagesat e kësteve sipas viteve për blerjen e lokalit**, duke marrë në konsideratë faktin se nuk janë deklaruar pagesa në DPV, në analizë u pasqyruan të dhënat e administruara nga subjekti (mandatpagesat), i cili nuk e provoi se kur u pagua kësti prej 15.000 euro, prandaj në këtë analizë kjo shumë u shpërnda në vitet 2010 dhe 2011 në shuma të barabarta.

**Në lidhje me huan e marrë nga z. Sh. P**, shuma u pasqyrua në tabelën e analizës financiare, por nuk u llogarit gjendje e mbetur *cash* në fund të vitit nga huaja, kjo pasi bazuar në dokumentacion dhe në DPV-të, subjekti nuk e saktësoi gjendjen *cash* në fund të çdo viti.

### Analiza financiare mbi mundësinë e blerjes së lokalit

Pershkrimi	2008	2009	2010	2011
<b>PASURI</b>	<b>797 268</b>	<b>353 495</b>	<b>10 775 276</b>	<b>9 924 110</b>
1. Lokal ne Rr. "Sami Frasheri", sip 75 m2			9 786 105	9 575 895
<b>DIFERENCA LIKUIDITETI (DIF. LIK. - LIKUIDITETE VITI PARAARDHES)</b>	<b>797 268</b>	<b>353 495</b>	<b>989 171</b>	<b>348 215</b>
<b>LIKUIDITETE (FUND VITI Dok.)</b>	<b>1 539 031</b>	<b>1 892 525</b>	<b>2 881 696</b>	<b>3 229 911</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>13 881 000</b>	<b>1 106 400</b>
1. Hua per blerjen e apartamentit 02.07.2010 Shani Peposhi			13 881 000	
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>797 268</b>	<b>353 495</b>	<b>-3 105 724</b>	<b>9 924 110</b>
<b>TE ARDHURA</b>	<b>1 379 812</b>	<b>1 827 299</b>	<b>1 721 654</b>	<b>1 617 441</b>
1. Te ardhura SR	931 851	1 089 352	1 238 591	1 183 756
2. Te ardhura b/shortja	447 961	487 947	483 063	433 685
3. Te ardhura nga shitja e makines		250 000		
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 128 405</b>	<b>1 882 509</b>	<b>1 161 408</b>	<b>1 031 913</b>
1. Shpenzime jetese	683 100	546 480	546 480	546 480
3. Shpenzime udhetimi	334 440	529 476	489 999	360 963
4. Shpenzime arsimimi vajza	110 864	123 453	124 929	124 470
<b>LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT</b>	<b>1 539 031</b>	<b>1 892 525</b>	<b>2 881 696</b>	<b>3 225 064</b>
1. Cash i deklaruar DPV	1 000 000	1 855 608	2 860 455	3 225 064
2. Banka Procredit Lejla Tominaj b/sh	25 097	7 547	9 673	0
3. Credins Bank, Blerim Tominaj			12 970	0
4. RBAL Blerim Tominaj	<b>251 924</b>	<b>29 370</b>	<b>-1 402</b>	
5. Union Bank Celjeta Tominaj	262 009			
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-545 861</b>	<b>-408 705</b>	<b>3 665 970</b>	<b>-9 338 582</b>

### Në lidhje me pasurinë "lokal", nga hetimi i kryer nga Komisioni u konstatua:

- Subjekti nuk ka deklaruar në vitin 2010, shumën e gjendjes *cash* që i ngeli nga huaja.
- Subjekti nuk justifikoi rritjen e gjendjes *cash*, deklaruar në vitet 2008 dhe 2009. Gjithashtu ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesat e kryera në vitin 2011, për blerjen e apartamentit në shumën totale prej 10.293.148 lekësh.
- Mospërputhje deklarimi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie;
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën "Vetting" huan në vlerën 8.000 euro, marrë huadhënësit E. S.
- Pagesat për blerjen e pasurisë i janë paguar shoqërisë "L-EM" sh.p.k., ndërkohë që shitës i pasurisë ka qenë z. A. B si individ;
- Në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar pagesën e dy kësteve të para, në shumën totale 63.000 euro në total.
- Subjekti nuk ka deklaruar në DPV pagesën e shumës prej 15.000 euro.
- Është e dyshimtë shitja e kësaj pasurie nga z. A. B në vlerën 10.000 euro, më lirë nga sa e bleu.

4. nxjerrje bankare *statement* i "I. S. B", e znj. E. P;

5. *statement* bankar i "A. B. P", e shoqërisë "G. C" sh.p.k., me administrator z. E. S i periudhës 1.1.2010 – 31.12.2011.

- Mospërputhje deklarimi për kursimet *cash* në DPV me shpjegimet e dhëna në pyetësor nga subjekti.

**Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.**

## **2.6 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

i. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti në DPV-në e vitit 2010 nuk ka deklaruar gjendjen *cash* që i ngeli nga huaja, subjekti në prapësimet e datës 5.6.2010, argumentoi se për aq kohë sa kjo hua nuk është administruar fizikisht nga subjekti, sikurse dhe e ka bërë prezent në shpjegimet e tij, nuk ka pasur arsye ta deklaronte gjendjen *cash* nga huaja. Shuma e huas, në bazë të kontratës, do t'i jepej subjektit për qëllimin për të cilin u dha, por nuk është administruar prej tij dhe në asnjë pikë të deklaratës nuk është thënë se shumta është në disponim real të tij. Kjo gjë bëhet fare e qartë gjatë pagesave të bëra, të cilat kanë qenë të shtrira në kohë dhe në shumta sipas likuiditeve që kishte kунati i subjektit në ato periudha.

ii. Në lidhje me konstatimin se nga analiza financiare e kryer subjekti rezulton me një mungesë burimesh të ligjshme për pagesat e kryera në vitin 2011, për blerjen e pasurisë lokal, në shumën totale prej 10.293.148 lekësh, subjekti argumentoi se ky përfundim duhet të jetë lapsus i Komisionit, pasi prona në fjalë është blerë me huan pa interes prej 100.000 euro, marrë shtetasit Sh. P dhe huan marrë shtetasit E.S, të cilët kanë rezultuar dhe rezultojnë financiarisht të konsoliduar për dhënien e shumave respektive.

Subjekti argumentoi se pjesa e detyrimit të tij në lidhje me këtë lokal është vetëm pjesa e shlyer nëpërmjet kursimeve gjatë viteve, të cilat kanë mbuluar plotësisht shumën në fjalë: *“Në analizën financiare referuar viteve në fjalë mbetet pa kuptim dhe tepër keqdashës fakti që pagesa e fundit prej 15.000 euro është pjesëtuar në dy vite, duke e shtuar në bilanc negativ ndërkohë që ajo dhe pjesa tjetër e burimeve të tij financiare në llogarinë më elementare duhej të ishte vlера e kursimeve, duke shtuar shumën e huave të marra për këtë qëllim siç dhe ka ndodhur realisht”*.

Në lidhje me faktin e burimeve të shtetasit Sh..P, i cili në atë periudhë ka marrë kredi, subjekti shpjegoi se: *“... është në logjikën e çdo personi që ka njohuritë më elementare të financës që marrja e një kredie nga një person zotëruar i mbi dy milionë euro pasuri të paluajshme, më së shumti është element që tregon sens praktik prej biznesmeni sesa të kundërtën”*.

Subjekti theksoi se shumta e huas, në asnjë rast, nuk është marrë *cash* prej tij dhe se pagesat janë bërë sipas mundësive të kунatit të tij, z. Sh. P.

iii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se nuk përputhet deklarimi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti shpjegoi se nuk ka asnjë mospërputhje në deklarimin e tij. Shumta prej 108.000 euro është marrë hua nga persona të afërt dhe financiarisht të konsoliduar për të dhënë shumta të tilla, kurse pjesa tjetër buron nga kursimet e tij gjatë viteve respektive. Ajo çka Komisioni vlerësoi se mungon është fakti se në deklarimin “Vetting” nuk është shkruar vlера prej 8.000 euro. Subjekti argumentoi se huaja prej 8.000 euro, jo vetëm që është deklaruar në kohën kur është marrë së bashku me deklaratën përkatëse, por dhe shlyerja e saj është deklaruar po në të njëjtën formë, ndaj ka gjykuar element keqdashës ngritjen e një pretendimi të tillë. Subjekti e konsideroi mosdeklarimin në deklaratën “Vetting” thjeshtë një *harresë*.

iv. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se pagesat për blerjen e pasurisë i janë paguar shoqërisë “L-EM” sh.p.k., ndërkohë që shitësi i pasurisë ka qenë z. A. B, si individ, subjekti shpjegoi se marrëdhënia fillestare ka qenë midis subjektit dhe shoqërisë “L- EM”, pasi ishte kjo shoqëri që do t’i shiste apartamentin në një pallat që po ndërtonte. Ndërkohë, subjekti ka bërë parapagime sipas kërkesës së shoqërisë “L- EM” dhe shpjegoi se shtetasi A. B për të nuk është njohur si individ në rrethana shoqërore, por si përfaqësues i shoqërisë me të cilën babai i tij ka lidhur kontratën për lokalin në Laprakë. Gjithë procedurat e marrëveshjeve mes z. A.T dhe shoqërisë “L- EM” janë negociuar prej tij, pra, në këtë kuptim për subjektin është njohur si person kompetent në shoqërinë në fjalë, ndaj dhe problemi që Komisioni konsideron si gjetje është i pavend.

Kur ndërtimi ishte drejt fundit, subjekti ka vizituar ambientin dhe ka parë që nuk ishte sipas karakteristikave të dakordësuara. Duke u vënë para përgjegjësisë, z. A.B ka ofruar zgjidhjen në fjalë, e cila ishte mundësi e mirë jo vetëm për destinacionin, por dhe për vlerën që ishte paguar në vijimësi. Subjekti, në përmbushje të marrëveshjes, kishte bërë parapagimet për apartamentin dhe shoqëria “L-EM” ishte debitore ndaj tij për t’i dorëzuar apartamentin sipas karakteristikave të dakordësuara. Ky detyrim i shoqërisë “L-EM” u përmbush nga ortakut dhe administratori i saj, individualisht, duke zëvendësuar debitorin në këtë marrëdhënie civile.

v. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se shitja e kësaj pasurie nga shitësi, z. A. B, në vlerën 10.000 euro më lirë nga sa e kishte blerë vetë është e dyshimtë, subjekti shpjegoi se nuk ka arsye për asnjë lloj dyshimi, pasi nuk ka qenë kurrë në dijeni të këtij fakti të cilin e ka mësuar nga komunikimi me Komisionin. Subjekti shpjegoi se në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk ka qenë në situatë të konfliktit të interesit me personin në fjalë, të afërm të tij apo persona të tjerë të shoqërisë.

Subjekti argumentoi se ky dyshim nuk duhet të paragjykojë çështjen dhe sa kohë është një dyshim pa rezultat apo i pambështetur nuk duhet të ishte marrë në konsideratë nga Komisioni për çështjen në fjalë, pasi nuk e prek atë. Subjekti u shpreh se: *“Unë nuk kam lidhje me marrëdhënien midis z. B dhe palën shitëse dhe nuk kam përse të penalizohem për këtë, pasi e kundërta cenon të drejtat e mia për një proces të rregullt dhe të drejtë. Më duhet të them se akoma njëra nga kontratat e lidhura për lokalin në fjalë, kontrata e dritave, megjithëse unë jam pronari i saj është në emër të shtetasit N.P, çka tregon qartësisht faktin se mes palëve A. B dhe N. P ka pasur një marrëdhënie kontraktore dhe unë konkretisht jam tërësisht jashtë këtyre marrëdhënieve”*.

Subjekti argumentoi se ka paguar paradhënie (vlera jo të pakta) te njerëz të besuar siç konsideron shtetasin A. B dhe ka marrë pronën, problemet e tjera të lidhjes se përse janë paguar te shoqëria “L-EM” etj., janë sqaruar me detaje dhe beson tej çdo dyshimi.

vi. Në lidhje me konstatimet e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar në vite këstet e pagesave për pasuritë e tij, z. Blerim Tominaj ka shpjeguar se nuk ka pasur asnjë detyrim prezantimin e këtyre pagesave për sa kohë ka paraqitur kontratën e huamarrjes në ILDKPKI dhe detyrimet në lidhje me pagesat dhe elementet e tjera në bindjen e tij, sipas të cilës edhe ka vepruar mbeten vetëm me huamarrësin. Subjekti shprehet se: *“Gjithashtu, diferencat që mbeteshin nga pagesat sipas periudhave nuk kanë qenë cash tek unë, por siç edhe ju është bërë e qartë kanë qenë*

*administruar prej kunatit. Në vitet në vijim në mënyrë tërësisht korrekte kam bërë prezent në ILDKPKI likuidimet dhe diferencat që mbeteshin ndaj huadhënësit”.*

## **2.7 Analiza ligjore**

i. Në lidhje me pretendimet e subjektit për gjendjen e mbetur *cash* të mosdeklaruar prej tij në DPV-në e vitit 2010 dhe shpjegimit se realisht nuk e ka disponuar këtë shumë pasi huanë se ka disponuar fizikisht, trupi gjykues arsyetoi se referuar akteve të administruara dhe deklarimeve të tij, z. Blerim Tominaj ka rezultuar debitor ndaj shtetasit SH. P, që nga viti 2010.

Në vitin 2010, subjekti deklaroi huan, megjithëse sipas deklarimeve të tij nuk e ka disponuar fizikisht. Pra, në kuptim të ligjit, subjekti e ka përmbushur detyrimin për deklarimin e huas. Ndërkohë, sipas shpjegimeve të tij, për blerjen e kësaj pasurie kanë rezultuar 2 pagesa të kryera për interes të subjektit dhe nga kjo hua (virtualisht) ka mbetur një shumë e caktuar. Pra, subjekti e konsideroi të arsyeshme deklarimin e huas, e cila ka shërbyer si burim për pasurinë, megjithëse nuk e ka disponuar fizikisht, por nuk e ka vlerësuar si të nevojshme deklarimin e pagesave të kësteve dhe gjendjen e mbetur. Subjekti nuk është bindës në shpjegime, për aq kohë sa pagesat e kryera nëpërmjet huas janë bërë për llogari dhe interes të tij. Arsyetimi i subjektit nuk mund të pranohet nga Komisioni me shpjegimin që nuk ka kryer vetë pagesat, për aq kohë sa ka qenë ai përfituesi final nga këto transaksione dhe se kunati i tij/huadhënësi kur ka kryer pagesat ka vepruar thjesht si ekzekutues i pagesës së shumave. Për sa më sipër, arsyetimi i subjektit nuk është bindës për Komisionin.

Në vijim të argumentit më sipër, Komisioni vlerësoi se sikurse subjekti ka shpjeguar që nuk e ka disponuar fizikisht huan e marrë, realisht nuk rezultoi asnjë gjurmë pagese *cash*, transfertë bankare apo çdo e dhënë tjetër direkte apo indirekte, që të mund të ketë element provueshmërie në lidhje me marrjen/përdorimin e kësaj huaje apo dhe kthimin mbrapsht të shumave.

Në vijim të këtij argumenti, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion se për blerjen e pasurisë ka shërbyer huaja e marrë te z. Sh.P.

Gjithashtu, në vijim të këtij argumenti, Komisioni arsyetoi se huadhënësi Sh. P ka aplikuar dhe i është *disbursuar* në datën 11.08.2010, një kredi në shumën 144.000 euro për blerje apartamenti me interes 7.93 %. Shuma e kredisë është transferuar në të njëjtën datë në llogarinë e shitësit. Për këtë arsye, Komisioni nuk pranoi pretendimin e subjektit, për faktin se z. Sh. P ka rezultuar vetë huamarrës.

Referuar kursimeve *cash*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2011 pakësimin e kursimeve të akumuluar dhe përdorimin e këtij të fundit si burim në financimin e blerjes së njësisë. Në lidhje me këtë fakt, referuar dhe qëndrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen 7/2019 JR, datë 28.2.2019, ku arsyetohet se: “[...] Kolegji orienton Komisionin që në trajtimin e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ... të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.”

**Në lidhje me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie.**

ii. Në lidhje me pagesat e kryera, pretendimet e subjektit se z. A.B ka zëvendësuar debitorin (shoqërinë “L –EM” sh.p.k.), pasi ky i fundit nuk përmbushi detyrimet karshi subjektit, Komisioni vlerësoi se z. Blerim Tominaj nuk ka provuar në ndonjë formë ekzistencën e ndonjë marrëdhënieje kontraktore me shoqërinë “L-EM” sh.p.k., për të mbështetur pretendimet e tij. Aktet e depozituara nga subjekti, mandatpagesat janë prova që tregojë se pagesat i janë kryer shoqërisë “L-EM” sh.p.k për apartamentin. Subjekti nuk ka referuar apo depozituar asnjë provë që të lidhë pagesat e kryera shitësit me pasurinë e blerë “Lokal”.

iii. Subjekti nuk solli asnjë argument apo provë për të mbështetur faktin pse shitësi e ka shitur këtë pasuri në vlerën 10.000 euro, më pak se çfarë e ka blerë.

Përfundimisht, për pasurinë “lokal”, Komisioni ka konstatuar:

- mungesë burimesh të ligjshme në shumën totale prej 10.293.148 lekësh, duke marrë parasysh huan, edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk e ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të huas, pasi mbeti e paprovuar kryerja e transaksionit ndërmjet tij dhe huadhënësit;
- mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin e krijimit;
- nuk u provuan me dokumentacion ligjor pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie;
- në DPV-në e vitit 2010 nuk ka deklaruar pagesën e dy kësteve të para, në shumën totale 63.000 euro;
- nuk është deklaruar në DPV pagesa e këstit të fundit në shumën 15.000 euro.

Komisioni ka vlerësuar se subjekti, me prapësimet dhe provat e paraqitura, nuk provoi bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurisë.

### **3. Apartament<sup>1</sup> me sip. 55 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen \*\*, Plazh, Durrës. Vlera: 26.500 euro.**

Pjesa takuese: 100 %.

Deklarimi në DPV: përfitur nga lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare.

Mënyra e fitimit: sipas dëshmisë testamentare me nr. \*\*\*, datë 24.5.2012.

#### **3.1 Burimi i krijimit**

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie nga babai i tij, subjekti ka shpjeguar<sup>2</sup> se blerja e kësaj pasurie është financuar nga e motra, znj. E. P.

#### **3.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**ZQRPP-ja<sup>3</sup>** nuk ka konfirmuar këtë pasuri në pronësi të subjektit apo të babait të tij.

---

<sup>1</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Aktmarrëveshje porosie datë 18.9.2004, midis shoqërisë ndërtuese “E.K.S.” sh.p.k. dhe shtetasit L. T; porositësi kërkon nga firma e ndërtimit ndërtimin e një apartamenti me sip. 53 m<sup>2</sup>, në vlerën 26.500 euro. Në ditën e lidhjes së kontratës janë paguar 10.000 euro.

- Vendim për lëshim të dëshmisë trashëgimie testamentare datë 5.3.2016. Nga provat shkresore të paraqitura nga kërkuesi Blerim Tominaj rezultoi se më 24.5.2012, i ndjeri L. T ka përpiluar testament noterial me nr. \*\* përpara noterit publik D. K. Testamenti është çelur me procesverbal nr. \*\*\*, datë 2.3.2016.

<sup>2</sup> Në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019.

<sup>3</sup> Më shkresën nr. \*\*\*prot., datë 4.3.2019.

**OSHEE-ja**<sup>1</sup> ka konfirmuar kontratë në emër të z. L. T, në instancën e Durrësit, pa dhënë detaje të tjera.

**ISSH-ja**<sup>2</sup> konfirmon se shtetasi L. J. T, i datëlindjes 5.1.1934, ka përfituar pension pleqërie.

### 3.3 Analiza e fakteve

Në dosjen e subjektit rezulton një aktmarrëveshje porosie, datë 18.9.2004, ndërmjet shoqërisë ndërtuese “E.K.S.” sh.p.k., me përfaqësues z. E. P, në cilësinë e ndërtuesit dhe z. L. T, në cilësinë e porositësit, sipas së cilës porositësi kërkon ndërtimin e një apartamenti me sip. 53 m<sup>2</sup>, në vlerën 26.500 euro. Në ditën e lidhjes së kontratës, nga porositësi është paguar shuma 10.000 euro.

Nga provat shkresore rezulton se më 24.5.2012, i ndjeri, z. L. T ka përpiluar testamentin noterial me nr. \*\* përpara noterit publik. Testamenti është çelur me procesverbal nr. \*\*\*, datë 2.3.2016. Në testament është disponuar se: *“I ndjeri L. T ka bërë testamentin me nr. \*\*\*, datë 24.5.2012, me anën e të cilit ka emëruar trashëgimtar, të cilëve u ka lënë trashëgim si më poshtë pasuri të paluajtshme, të luajtshme dhe vlera materiale dhe monetare. Djalit Blerim Tominaj do t' i mbeten pronat, vlerat materiale dhe monetare të miat, si më poshtë:*

- *Apartament, kati \*\* në lagjen \*\*, I, Durrës me sip. 53 m<sup>2</sup>, të cilën e kam përfituar me në bazë të kontratës së sipërmarrjes lidhur me shoqërinë ‘E.K.S.’ sh.p.k., cit. 18.9.2004.*
- *Një lokal i ndodhur në ‘Rr. D’ me sip. 179 m<sup>2</sup>, kati i \*\* i përfituar nga kontrata e sipërmarrjes me firmën ‘L-EM’ sh.p.k., regjistruar me nr. \*\*\*, datë 7.5.2008.*
- *45 monedha të arta franceze të quajtura 5-she, secila nga 32.4 gram”.*

Komisioni i ka kërkuar informacion subjektit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, i cili ka shpjeguar se<sup>3</sup>: *“...motra e subjektit investoi sasinë e parave për blerjen e këtij apartamentit prej 55 m<sup>2</sup> pikërisht në këtë vend e diktuar dhe nga specifika e sëmundjes së babait, i cili edhe atë vit kishte 70-vjetorin e lindjes...”.*

Subjekti ka depozituar një deklaratë dore, lëshuar nga znj. E. P, (e motra), ku shpjegon se me pëlqimin e bashkëshortit të saj, në vitin 2004, ka financuar blerjen e një apartamenti në plazh I. Durrës, me vlerë 22.000 euro.

Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit ka depozituar 3 mandatarkëtime: nr. \*\*, datë 18.9.2004, paguar shuma 10.000 euro, për shoqërinë ndërtuese “A”, tek investitori L. P nuk rezulton emri i personit që bën arkëtimin e kësaj shume; nr. \*\* prot., datë 26.5.2005; në shumën 4.000 euro, paguar nga shtetasi L.T, pa u specifikuar për interes të kujt bëhet kjo pagesë; nr.\*\* prot., datë 3.2.2005, z. L.T paguan shumën prej 10.000 euro. Rezulton dhe një vulë me përshkrimin av. L. P.

Nga përshkrimi i akteve të mësipërme, asnjë nga mandatpagesat nuk rezulton të jetë kryer për llogari të shoqërisë ndërtuese “E.K.S” sh.p.k., me përfaqësues E. P, me të cilën z. L. T ka nënshkruar marrëveshjen për porositjen e apartamentit. Nga aktet e depozituara nga subjekti nuk provohet që pagesat për blerjen e pasurisë të shoqëria “E.K.S” sh.p.k., t’i ketë bërë z. L. T.

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2019.

<sup>3</sup> Në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019.

**Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk provoi pretendimet e tij për pagesat e kryera nga babai për apartamentin në Durrës.**

### 3.4 Analiza financiare

Subjekti deklaroi se kjo pasuri është financuar nga motra e tij dhe nuk e mbështeti deklarinimin e tij. Në këto kushte, Komisioni kreu analizën financiare të mundësisë së prindërve të tij për të blerë pasurinë apartament në periudhën 2004 - 2005, si paraqitet në tabelën më poshtë, ku:

- të ardhura të ligjshme për efekt të analizës financiare janë konsideruar të ardhurat nga pensionet respektive, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi, në shumën 800.000 lekë sipas kontratës së datës 17.5.1995, si dhe të ardhurat nga shitja e dyqanit në shumën 400.000 lekë, sipas kontratës së datës 14.2.2001;
- në analizë nuk janë llogaritur shpenzime jetese, pasi subjekti ka pranuar se prindërit pensionistë kanë jetuar me të dhe se nuk kanë përdorur pensionet për shpenzime jetike.

Përshkrimi	Vitet	Viti
	<b>1993-2004</b>	<b>2005</b>
<b>1. Te ardhurat</b>	<b>2 570 091</b>	<b>193 744</b>
Pensioni Lavdrim Tominaj	700 098	96 830
Pensioni Flutura Tominaj	669 993	96 914
Te ardhura nga shitja e baneses dhe dyqanit ne Diber	1 200 000	
<b>2. Pasuri</b>	<b>1 267 400</b>	<b>2 179 994</b>
1. Apartament Durres, Plazhi Iliria 26.500 euro	1 267 400	1 979 910
Ndryshim likuiditeti	-	200 084
<b>Rezultati (1-2)</b>	<b>1 302 691</b>	<b>-1 986 250</b>

Në lidhje me pasurinë apartament në Durrës u konstatua se:

- nuk u provuan pagesat e kryera nga babai i subjektit;
- nuk u provua financimi i kësaj pasurie nga motra e subjektit;
- prindërit e subjektit kanë mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar pasurinë dhe për të përballuar shpenzimet në shumën 1.986.250 lekë.

**Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.**

### 3.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

i. Subjekti, në prapësime ka kundërshtuar gjetjet e Komisionit, duke shpjeguar se:

*“...referuar Kodit Civil dhurimi nuk është i detyrueshëm që të behet me shkresë. Dhurimi i një shume parash mund të bëhet edhe verbalisht dhe në kontekstin kur dhurimi i parave bëhet nga vajza te babai, nënshkrimi i një kontrate është i tepruar e i padomosdoshëm, për të mos thënë fyes për familjen me baza e parime të forta, aq më tepër kur këto para jepeshin dhuratë”. Prova që subjekti ka paraqitur në këto raste, pra, deklarata e motrës së tij për dhënien e parave, është prova e vetme që mund të paraqitet në të tilla raste.*

Subjekti ka vijuar se në asnjë rast Komisioni nuk e ka kundërshtuar ligjshmërinë e deklaratës së të motrës apo të ketë pretenduar se është e falsifikuar, apo të ketë goditur këtë provë, si dhe



në asnjë rast nuk ka argumentuar përse ajo provë është e papranueshme. Prova është paraqitur dhe, për pasojë, gjetja e Komisionit duhet të kishte qenë mbi këtë provë dhe jo “*nuk provohet financimi i kësaj pasurie nga e motra*”. Gjithashtu, subjekti ka vijuar se ky konstatim dhe gjetja e Komisionit, e paarsyetuar, tregon edhe një herë paragjykimin e vlerësimit ndaj tij, duke cenuar të drejtën e tij për një proces të drejtë.

Subjekti argumenton se nuk është as çudi dhe as sakrilegj që vajza, e ndodhur në kushte të shkëlqyera ekonomike, ku së bashku me fëmijët e saj janë zotërues të më tepër se 7-8 pronave të patundshme, duke përfshirë dhe një në shtetin e Floridës SHBA, të dhurojnë me rastin e 70-vjetorit të babait një pronë, e cila për kushtet e saj ka qenë më pak se modeste. Mënyra e fitimit të kësaj pasurie është tërësisht e ligjshme nëpërmjet një dokumenti testamentar, i cili njihet si një mënyrë e fitimit të pronësisë.

ii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se nga dokumentacioni i administruar nuk provohen pagesat e kryera nga babai i subjektit, në prapësime, subjekti ka argumentuar se nuk e kupton se përse nuk bëhet dot lidhja mes mandateve të pagesave dhe shoqërisë ndërtuese, ku arkëtare duket qartësisht se është shtetasja L.P notere dhe avokate e shoqërisë, si dhe nëna e përfaqësuesit të shoqërisë E. P.

Nuk rezulton në asnjë rast dhe për asnjë arsye, që në datat e kryerjes së këtyre pagesave i ndjeri, babai i tij, të mos ketë qenë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në pamundësi absolute fizike dhe mendore për të kryer një veprim të tillë.

Në funksion të së vërtetës dhe vetëm të së vërtetës, subjekti ka argumentuar se ka sjellë si provë dokumentacionin e plotë të disponuar nga firma ndërtuese, në të cilat janë pasqyruar jo vetëm mandatpagesat, por edhe listat dhe regjistrat e pagesave sipas klientëve.

iii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se babai i ka lënë me testament subjektit një pasuri të financuar nga e bija, subjekti ka argumentuar se motra dhe fëmijët e saj kanë disponuar vila në zonën e plazhit të Qerretit, për këtë arsye, babai i tij mendonte se një apartament me sip. 53 m<sup>2</sup>, tek I nuk ishte një aset i domosdoshëm për motrën.

Sipas deklaratës bashkëngjitur prapësimeve të subjektit, nëna e tij ka shkruar se testamenti është bërë në marrëveshje me të dhe në lidhje me apartamentin në Durrës sqaron se ka dijeni që pagesat janë bërë nga vajza e saj, E. P dhe gjithashtu ka qenë pjesë e diskutimit me të ndjerin për faktin se kujt do t’ia trashëgonte. Gjithashtu, nëna e subjektit shton se ka qenë iniciatore e marrjes së një aprovimi edhe nga vajza e saj (motra e subjektit), e cila është shprehur se –*ajo është thjeshtë një kafe për ne*. Subjekti pretendon se dyshimet e Komisionit duken që janë spekulime për të shndërruar një realitet në diçka që nuk është, duke mos u bazuar në provat e sjella dhe cenuar kështu të drejtën e subjektit për një proces të rregullt e të drejtë vlerësimi.

### **3.6 Analiza ligjore**

i. Komisioni ka arsyetuar se subjekti, si përfituesi i kësaj pasurie, për shkak të procesit të rivlerësimit dhe bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ka detyrimin ligjor që të provojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të përfituara prej tij. Komisioni, në procesin e rivlerësimit të pasurive, kontrollon pasuritë e subjekteve, deklarimin e tyre, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit. Në këtë kuptim, nga subjekti duhet të ishin paraqitur prova e shpjegime në nivelin e provueshmërisë, të krijuara me burime të ligjshme.

Në vijim, Komisioni vlerëson se deklaratat e të motrës apo ajo e nënës së tij në lidhje me këtë pasuri, janë në nivel deklarativ, të pashoqëruara me dokumentacion ligjor, të cilat nuk justifikojnë dhe nuk kanë nivelin e provueshmërisë për të provuar pas 16 vjetësh që nga momenti i dhurimit se pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie, në vitin 2004, janë kryer nga motra e subjektit, aq më shumë, që në përfundim, përfitues i saj rezultoi vetë subjekti.

ii. Në lidhje me pagesat e kryera, subjekti ka sjellë të njëjtat mandatarkëtime që kishte depozituar gjatë hetimit administrativ, si dhe një vërtetim lëshuar nga znj. L. P. Në këtë vërtetim deklarohet se: “... me anë të kontratës së shitblerjes nr.\*\*\*, datë 20.2.2002, L. P, N. D dhe I. D kanë blerë një shtëpi banimi një vilë 1 katëshe me sip. 500 m<sup>2</sup>. Kundrejt të gjitha rregullave të urbanistikës, mbi këtë truall kanë ndërtuar një godinë 5-katëshe, nga firma ndërtuese ‘A’ me administrator K.I. Deklaruesja vijon se në këtë godinë ka blerë apartament shtetasi L. T, me sip. 53 m<sup>2</sup>, në vlerën 26.250 euro, nëpërmjet 3 mandatpagesave:

1. mandatarkëtim nr. \*\*, datë 18.9.2004, shuma 10.000 euro;
2. mandatarkëtim nr. \*\*, datë 3.2.2005, shuma 10.000 euro;
3. mandatarkëtim nr. \*\*, datë 26.5.2005, shuma 4.000 euro.

*Mandatarkëtimet nr. \*\* dhe \*\* janë firmosur nga unë L. P, ndërsa mandatarkëtimi nr. \*\* është firmosur nga bashkëshorti im. Këto lekë janë marrë nga bashkëpronarët”.*

Komisioni ka arsyetuar se referuar akteve të depozituara nga subjekti, babai i ndjerë L. T, ka nënshkruar aktmarrëveshje porosie, datë 18.9.2004, me shoqërinë ndërtuese “E.K.S” sh.p.k., përfaqësuar nga ortakët (në cilësinë e ndërtuesit) A. K, P. D dhe E. P dhe z. L.T. Në fund kanë nënshkruar të gjithë ortakët përfaqësues të shoqërisë së ndërtimit. Për sa më sipër dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe vërtetimin lëshuar nga znj. L. P, Komisioni çmon se megjithëse është nëna e njërit prej ortakëve të shoqërisë ndërtuese, sikurse deklarohet nga subjekti, nuk arrin të provojë se pagesat janë kryer në favor të shoqërisë “E.K.S” sh.p.k., e cila ka lidhur kontratë me z. L.T, në interes të së cilës duhet të ishin kryer pagesat. Në kushtet kur pasuria nuk është regjistruar dhe nuk mund të provohet se cilët janë pronarët e pasurisë sipas certifikatës me aktet që disponojmë dhe që ka depozituar subjekti, Komisioni çmon se znj. L. P, nuk legjitimohet që të deklarojë se pagesat e kryera sipas vërtetimit lëshuar prej saj, të jenë bërë për interes të shoqërinë me të cilën porositësi ka lidhur kontratën. Nuk ka asnjë akt ligjor të depozituar nga subjekti, që ta legjitimojë të shprehet apo të lëshojë vërtetime në emër të shoqërisë “E.K.S” sh.p.k., që i ndjeri L.T, kishte lidhur kontratën.

**Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.**

#### **4. Pasuria “lokal”<sup>1</sup>, me sip. 179 m<sup>2</sup>, ndodhur në “Rr. D”, Tiranë.**

Vlera e deklaruar: 170.050 euro.

---

<sup>1</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* datë 7.5.2008, ku z. L. T, blen dyqanin me sip. 179 m<sup>2</sup>, kati i \*\* në “Rr. D”, nga shoqëria ndërtuese “L-EM sh.p.k. Çmimi i shitjes së dyqanit është 950 euro/m<sup>2</sup> dhe në total 170.050 euro, të cilat janë likuiduar nga porositësi në favor të sipërmarrësit para redaktimit të kontratës jashtë zyrës noteriale dhe pa pretendim nga palët.
- Vendim për lëshim të dëshmisë së trashëgimisë testamentare datë 5.3.2016, ku i ndjeri L.T ka ndërruar jetë më 13.11.2015. Nga provat shkresore të paraqitura nga kërkuesi Blerim Tominaj rezulton se në datën 24.5.2012, i ndjeri L. T ka përpiluar testament noterial me nr. \*\* përpara noterit publik D. K. Testamenti është çelur me procesverbal nr. \*\*\*, datë 2.3.2016. Në të disponohet shprehimisht se: i ndjeri L. T ka bërë testament me nr. \*\*, datë 24.5.2012 me anën e të cilit djalit, Blerim Tominaj, do t’i mbetet “Një lokal i ndodhur në ‘Rr.D’, me sip. 179 m<sup>2</sup>, kati \*\*”, i përfutur nga kontrata e sipërmarrjes me firmën “L-EM” sh.p.k., regjistruar me nr. \*\*\*, datë 7.5.2008.

Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit: dëshmia testamentare me nr. \*\*\*, datë 24.5.2012, lëshuar nga i ndjeri L. T.

#### 4.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

**ZVRPP-ja Tiranë<sup>1</sup>** nuk ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie në emër të subjektit apo të babait.

**OSHEE-ja<sup>2</sup>** ka konfirmuar kontratë në emër të z. L. T, në instancën e Tiranës, me adresë: “RR D”, pallati L-EM, me datë hapje 23.8.2007.

**UKT<sup>3</sup>-ja** ka informuar se në emër të z. Blerim Tominaj, referuar sistemit të menaxhimit të informacionit, identifikohet një kontratë me adresë “Rr . D”, Tiranë. Kontrata është me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve privat, me detyrime të likuiduara deri në muajin nëntor 2018.

**ISSH<sup>4</sup>-ja** ka konfirmuar se shtetasi L. J. T, i datëlindjes 5.1.1934, ka përfituar pension pleqërie nga marsi i vitit 1993 e në vijim në shumën 14.586 lekë/muaj.

#### 4.2 Analiza e fakteve

Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të përfituar nga babai, sipas dëshmisë testamentare me nr. \*\*, datë 24.5.2012. Në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie nga babai, subjekti ka depozituar kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 7.5.2008, nënshkruar ndërmjet sipërmarrësit shoqërisë “L-EM” sh.p.k., dhe porositësit z. L. T. Sipas këtij akti një sipërfaqe ndërtimi prej 179 m<sup>2</sup>, do t'i shitet blerësit në çmimin prej 170.050 euro. Çmimi i blerjes është likuiduar nga porositësi në favor të sipërmarrësit, para redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale dhe pa pretendime nga palët. Sipas nenit 2 të kontratës, shoqëria “L-EM” sh.p.k., pas likuidimit të plotë të vlerës së dyqanit dhe nënshkrimit të procesverbalit të marrjes në dorëzim, do të marrë të gjitha masat për hartimin e kontratës së shitjes dhe regjistrimin e dyqanit në ZVRPP, brenda afatit kohor prej 3 vjetësh.

Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e kësaj pasurie nga babai, dokumentacion provues mbi pagesat e kryera në shumën totale, informacion të detajuar, si dhe dokumentacion mbi përdorimin e dyqanit që nga momenti i blerjes.

Pavarësisht kontratës dhe shënimit të saj për vlerën, pagesa e kryer nga babai është në shumën prej 70.000 euro dhe pranë shoqërisë së ndërtimit nuk është bërë asnjë lloj pagese tjetër, sepse babai i tij ka ndërhyrë duke zëvendësuar blerësin e mëparshëm. Subjekti ka shpjeguar<sup>5</sup> si vijon:

*“Shtetasi A. T, i cili është djali i dajës, M. T biznesmen në fushën e farmaceutikës në Maqedoni, Kosovë, për nevojat e tij të biznesit kishte blerë një lokal në Seksion \* të pallatit në Laprakë, në një kat të mesëm mes të parit dhe të dytit me sipërfaqe prej 140 m<sup>2</sup> sipas kontratës bashkëngjitur.*

*Shpjegoj se informohem nga A. T se në katin ku kishte porositur pasurinë e tij, në këtë seksion deri në gjithë lartësinë e seksionit kishte prenotuar sipërfaqe edhe ‘P.C. Bank’. Për shkak të*

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. K \*\*\* prot., datë 16.1.2019.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>5</sup> Në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019.

*elementeve të sigurisë ata kishin ndërmjetësuar më shtetasin A. B për të blerë seksionin nga kati përdhe, duke përfshirë edhe pjesën e A. Sipas fjalës së përfaqësuesve të shoqërisë gjatë bisedave më bankën, nëse nuk do të kishin gjithë seksionin në përdorim, atëherë kontrata mes tyre, e cila flitej të ishte goxha e madhe në vlerë mund të prishej çka konsiderohej nga përfaqësuesit e firmës si dëm i pallogaritshëm për firmën.*

*Duke qenë se siç duket nuk është gjetur zgjidhje, djali i dajës ka ardhur në Tiranë dhe ka kryer gjitha tratativat me firmën në fjalë. Duke qenë se A ishte i huaj dhe mund të nënvleftësohej apo të injorohej e drejta e tij për çfarë kishte ndodhur, më kërkoi që ta asistojta me prezencën time në bisedimet me përfaqësues të firmës. Unë kam shoqëruar A gjatë fazës mbyllëse të bisedimeve, ku dhe është prezantuar për herë të parë me problemin dhe shtetasin A. B.*

*Përfaqësuesit e firmës ishin koshientë për çfarë kishin kryer dhe ishin të gatshëm për të gjetur zgjidhje me mirëkuptim duke ofruar sipërfaqe shtesë deri në 50-60 m<sup>2</sup> pa çmim shtesë, brenda ambienteve të tyre ose dhe më tepër se kaq, por kundrejt pagesave tej kësaj sipërfaqeje.*

*Duke qenë se sido dhe sado të ishte sipërfaqja e ofruar tej vendit ku ai e vlerësonte si të përshtatshme për qëllimin e tij, A insistonte vetëm për kthimin e shumës qoftë dhe pa interesa dhe përfundimisht u ra dakord më mirëkuptim të plotë që qoftë firma, qoftë A të gjenin një blerës për lokalin e tij sipas çmimit me qëllim që ai të merrte paratë e investuara nga ky blerës dhe firma do të bënte kompensimin e blerësit pa ndryshim çmimi.*

*Si njerëzit me të afërt të tij në Tiranë, A ka biseduar me babain tim dhe i ka propozuar që ta zëvendësojë në këtë marrëdhënie duke i paguar 70.000 euro dhe duke marrë pronën sipas propozimit të firmës. Babai, duke parë sipërfaqen dhe çmimin, pavarësisht efektshmërisë thujtse minimale të ambientit ra dakord, duke zgjidhur këtë problem me A. Pra, pavarësisht kontratës dhe shënimit të saj për vlerën, pagesa e kryer është në shumën prej 70.000 euro dhe pranë firmës në fjalë nuk është bërë asnjë lloj pagese. Pas dakordësisë dhe lënies së një farë kohe për saktësim të qëndrimeve, ka ardhur A, ka hequr dorë nga kontrata dhe në të njëjtën ditë është lidhur në emër të tim eti.*

*Shpjegoj se në dijeninë time ambienti nuk është dhënë me qira pas vitit 2015 dhe këtë fakt e deklaroj me përgjegjësi pasi prej vitesh shpenzimet e dritave dhe ujit që paguhen së bashku me shpenzimet e ujit e dritave të familjes janë vetëm shpenzime mirëmbajtjeje. Në këtë ambient nuk është kryer asnjë investim. Nuk disponoj asnjë dokumentacion në lidhje me këtë periudhë”.*

### **4.3 Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në deklaratën noteriale<sup>1</sup> nr. \*\*\*, datë 30.11.2018, z. A. T, ka konfirmuar pretendimet e deklaruar nga subjekti. Gjithashtu, ka deklaruar se pagesa prej 70.000 euro i është dhënë nga babai i subjektit, në disa këste dhe një pjesë të saj, rreth 20.000 euro, e ka marrë në monedha floriri.

Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka depozituar dokumentacionin, si vijon:

1. Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.10.2006, nënshkruar ndërmjet shoqërisë sipërmarrëse ndërtuese “L-EM” sh.p.k., dhe porositësit A.T për shitjen e një pasurie me sipërfaqe ndërtimi në total 140 m<sup>2</sup>, kati \*\*, Seksioni \*\*, me pamje nga shkolla 9- vjeçare “28 – 29 Nëntori”. Në nenin 3 të kontratës është parashikuar “Palët bien dakord që çmimi

<sup>1</sup> Ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.02.2020

i shitjes së dyqanit objekt kontrate të jetë 70.000 euro, të cilat janë likuiduar nga porositësi, në favor të sipërmarrësit para redaktimit të kësaj kontrate jashtë kësaj zyre dhe pa pretendime nga palët”.

2. Akt noterial nr. \*\*\*\*, datë 7.5.2008, me përshkrimin “revokim kontrate sipërmarrje”, sipas së cilës shoqëria ndërtuese “L-EM” sh.p.k., dhe z. A. T kanë nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje me nr. \*\*\*, datë 12.10.2006, redaktuar nga noter A. T, sipas të cilës z. A. T kishte porositur që më parë të blejë dyqanin me sipërfaqe ndërtimi në total 140 m<sup>2</sup>, kati i \*\*, seksioni \*\*, me pamje nga shkolla 9- vjeçare “28 – 29 Nëntori”. Palët kanë rënë dakord që të revokojnë kontratën e mësipërme të sipërmarrjes, duke i kthyer shoqërisë “L- EM” sh.p.k., z. A. T, shumën e paguar prej 70.000 euro, të paguar nga porositësi për blerjen e dyqanit.
3. Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 7.5.2008, nënshkruar ndërmjet shoqërisë sipërmarrëse ndërtuese “L-EM” sh.p.k., dhe porositësit L. T për shitjen e dyqanit nr. \*\* C, me sipërfaqe ndërtimi në total 179 m<sup>2</sup>, kati \*\*, seksioni \*\*, me pamje nga shkolla 9-vjeçare “28 – 29 Nëntori”. Në nenin 3, të kontratës është parashikuar: “Palët bien dakord që çmimi i shitjes së dyqanit objekt kontrate të jetë 170.050 euro, të cilat janë likuiduar nga porositësi në favor të sipërmarrësit para redaktimit të kësaj kontrate jashtë zyrës noteriale dhe pa pretendime nga palët”.
4. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.12.2018, para noterit Gj.K. Deklaruesi ka deklaruar se: *“Më 12.10.2006 në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë ‘L-EM’ sh.p.k. kemi lidhur me shtetasin maqedonas A. T, përpara noterit A.T, kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 12.10.2006. Sipas kësaj kontrate sipërmarrjeje ne si shoqëri investitore merrnim përsipër të ndërtonim një dyqan me sipërfaqe ndërtimi në total 140 (njëqind e dyzet) m<sup>2</sup> buzë rruge, kati \*\*, Seksioni \*\* (seksion, i cili aktualisht është ‘P.C. Bank’). Në lidhje me këtë ndërtim shtetasi A. T likuidoi pranë shoqërisë ndërtuese ‘L-EM shumën prej 70,000 (shtatëdhjetë mijë) eur,o të caktuar si vlerë të dyqanit.*

*Për shkak të marrëveshjes së bërë nga shoqëria ‘L-EM’ me ‘P.C. Bank’ sh.a., e cila kërkoi të blejë në gjithë lartësinë në Seksionin \* dhe pjesërisht në Seksionin \* të objektit, duke kushtëzuar në këtë mënyrë largimin e të gjithë personave, të cilët kishin prenotuar ambient në atë seksion, pra, rrjedhimisht dhe ambientin ku ndodhej dyqani i prenotuar nga shtetasi A. T.*

*Pasi arritëm të kontaktojmë me z. A. T, kërkua mirëkuptimin e tij dhe i ofruam sipërfaqe të tjera në seksione të tjera të godinës, duke ofertuar të merrte me të njëjtin çmim të paguar, sipërfaqe më të mëdha se ajo çfarë ai kishte në kontratë.*

*Pas disa muajsh tratativa dhe pamundësisë sonë për likuiditet u ra dakord që nga dyqani i prenotuar në seksionin \* me një sipërfaqe prej 140 m<sup>2</sup>, të kalohej në një seksion tjetër, ku ai kishte parë një dyqan me sipërfaqe prej 180 m<sup>2</sup>, të cilin do t'ia ofronte një blerësi tjetër dhe në momentin e lidhjes së kontratës me blerësin e ri të bëhej dhe revokimi i kontratës së tij. Në datën 7.5.2008 është paraqitur me shtetasin L. T (i afërm i tij), i cili pranoi që për të njëjtin vlerë prej 70,000 (shtatëdhjetë mijë) euro të blinte një sipërfaqe më të madhe, pikërisht, dyqani, nr. (\*\*), me sipërfaqe ndërtimi në total 179 m<sup>2</sup> (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë), kati \*\*, Seksioni \*.*

*Pasi u bë revokimi i kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*, datë 12.10.2006 me shtetasin A. T, në të njëjtën datë u lidh kontrata e re me shtetasin L.T për dyqanin prej 180 m<sup>2</sup> sipas përshkrimit më sipër, duke u konsideruar e likuiduar e duke zgjidhur në këtë mënyrë të gjitha problemet financiare mes palëve.*

*Sa më sipër, palët nuk kishin më asnjë detyrim ndaj njëri- tjetrit dhe lidhur me këtë deklaram nuk kanë asnjë pretendim sot apo në të ardhmen”.*

**Komisioni, në vlerësim të dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit arriti në përfundimin se deklaratimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi, nëse babai i subjektit, e kishte blerë pasurinë prej 179 m<sup>2</sup>, me çmimin 70.000 euro, ky fakt do të pasqyrohej në kontratë. Në dokumentin ligjor kontratë shitje, palët me vullnetin tyre të lire kanë përcaktuar çmimin e blerjes në shumën 170.050 euro. Gjithashtu, subjekti nuk depozitoi dokumentacion provues që babai i tij, të ketë kryer ndonjë pagesë.**

#### **4.4 Në lidhje me të ardhurat e ligjshme për blerjen e kësaj pasurie**

Komisioni i kërkoi subjektit të ardhurat e ligjshme, që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë “lokal”.

Subjekti, për të provuar të ardhurat e babait, ka depozituar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- vërtetim nga ISSH-ja nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019, sipas të cilit z. L. T, ka përfituar të ardhura nga sigurimet shoqërore në shumën prej 2.222.684 lekësh, për periudhën 5.7.1984 – 13.11.2015;
- deklaratë të thjeshtë, lëshuar nga z. Dh. N me profesion rrobaqepës, sipas së cilës deklaroi se në fundin e vitit 1995, kur u largua për të banuar në Tiranë, z. L. T, i ka kaluar dyqanin e rrobaqepësisë në qendër të qytetit të administruar prej tij. Për këtë arsye i ka paguar shtetasit L.T vlerën prej 100.000 lekësh të vjetra në muaj për çdo muaj, nga fillimi i vitit 1996 deri në fillim të viti 2001, duke përfshirë këtu edhe vlerën e mallit të lënë për shitje. Bashkëngjitur kësaj deklarate nuk ka ndonjë dokumentacion;
- deklaratë noteriale, lëshuar nga z. L. K, i cili deklaroi se ka qenë 1 nga 3 punonjësit që ka punuar për z. L. T, i cili ka qenë rrobaqepës dhe se ka pasur klientelë të madhe në Peshkopi.

Dy kontrata noteriale:

1. kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.2.2001, sipas së cilës z. L.T, i shet z. Xh. I një lokal, në shumën 400.000 lekë, privatizuar nga shitësi në vitin 1991;
2. kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 17.5.1995, sipas së cilës shitësi L. T, i shet z. M. B, pasurinë apartament 2+1, në Peshkopi, në shumën 800.000 lekë.

Për sa më sipër, subjekti mundi të justifikojë me dokumentacion ligjor si të ardhura të ligjshme të babait të tij, shumën prej 1.200.000 lekësh, nga shitja e apartamentit dhe dyqanit në Peshkopi, si dhe të ardhurat nga pensionet e prindërve.

#### **4.5 Analiza financiare**

Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2008 për të përlllogaritur aftësitë paguese të prindërve për të blerë pasurinë “lokal”. Çmimi i blerjes për këtë pasuri është konsideruar çmimi i parashikuar në kontratën noteriale të shitblerjes. Për efekte të analizës dhe për të qenë sa më objektiv, Komisioni në analizë ka përfshirë edhe shumën prej 20.000 euro, si të paguar në monedha ari, e konvertuar në lekë në shumën 2.463.650 lekë.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2008</b>
<b>1. Te ardhurat</b>	<b>2 687 820</b>
Pensioni Lavdrim Tominaj	115 097
Pensioni Flutura Tominaj	109 073
Monedha floriri te konvertuara ne 20.000 euro	2 463 650
<b>2. Pasuri</b>	<b>20 198 221</b>
1. Lokal, Rruga e Durresit	20 941 025
Ndryshim likuiditeti	- 742 804
<b>3. Shpenzime</b>	<b>123 183</b>
Shpenzim (dhurate mbeses per shkollen 1.000 eur cdo vit)	123 183
<b>Rezultati (1-2-3)</b>	<b>-17 633 583</b>

**Nga analiza e kryer për vitin 2008 ka rezultuar se prindërit e subjektit kishin mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në shumën 17.633.583 lekë.**

#### **4.6 Në lidhje me disponimin e pasurisë “lokal”**

Subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar<sup>1</sup> se: *“Në dijeninë time ambienti nuk është dhënë me qira, pas vitit 2015 këtë fakt e deklaroj me përgjegjësi, pasi prej vitesh shpenzimet e dritave dhe ujit që paguhen së bashku me shpenzimet e ujit e dritave të familjes janë vetëm shpenzime mirëmbajtjeje. Nuk është kryer asnjë investim në ambientin në fjalë. Nuk disponoj asnjë dokumentacion në lidhje me këtë periudhë.”*

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se në llogaritë bankare të z. L. T, vërehen:

- kreditime të rregullta mujore me përshkrimin “pagesa qiraje” në shumën 1.200 euro, nga shtetasi E. Sh për periudhën prill 2010 - prill 2011;
- kreditime të rregullta për pagesa qiraje nga shoqëria “A.O.C I” sh.p.k., dhe nga shtetasi A. L, duke filluar nga maji i vitit 2011 e në vijim; si dhe
- në datën 4.2.2011, z. Blerim Tominaj ka tërhequr nga llogaria e z. L.T shumën prej 10.500 euro dhe në datën 21.12.2011 ka tërhequr shumën prej 11.000 euro.

Subjekti<sup>2</sup>, i pyetur për sa me sipër, ka shpjeguar se babai ka pasur kontratë qiraje për pasurinë e tij me një shoqëri bastesh sportive, e cila ka vazhduar deri në shtator të vitit 2011. Subjekti deklaroi se nuk mban mend veprimet konkrete të tërheqjes nga llogaria e babait, por konfirmoi se këto shuma janë administruar nga nëna e tij.

**Në lidhje me pasurinë “lokal”, Komisioni ngriti dyshimin e arsyeshëm për pasuri të fshehur të subjektit për faktin se:**

- nuk provohen pagesat e kryera nga babai i subjektit për blerjen e lokalit;
- u konstatua mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e lokalit nga babai i subjektit;
- të ardhurat e gjeneruara nga kjo pasuri, në llogarinë e babait janë tërhequr nga subjekti;
- subjekti ka deklaruar çmim më të ulët blerjeje, nga çfarë kanë parashikuar palët në kontratën e sipërmarrjes.

<sup>1</sup> Në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.10.2019, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2019.

<sup>2</sup> Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. \*\* prot., datë 13.2.2020.

**Në lidhje me sa më sipër, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.**

#### **4.7 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

i. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se nuk provohen pagesat e kryera nga babait i subjektit për blerjen e lokalit, subjekti ka shpjeguar se: *“...është e vërtetë që kontrata e lidhur midis L. T dhe shoqërisë ‘L-EM sh.p.k., përcakton se çmimi është likuiduar jashtë zyrës noteriale, por likuiduar nuk do të thotë detyrimisht paguar cash. Likuiduar do të thotë shlyer/përmbushur detyrimi për pagesën që në rastin konkret ka ndodhur nëpërmjet zgjidhjes së pretendimeve të z. A.T ndaj shoqërisë ‘L-EM’ sh.p.k., nëpërmjet pagesës së çmimit të rënë dakord midis shtetasve A. T dhe L.T.*

*Në asnjë rresht të komunikimeve me Komisionin nuk është pretenduar se L. T ka kryer pagesa te shoqëria për lokal, pasi nuk kishte dhe përse të paguhej për sa kohë që detyrimi i tij ishte me shtetasin A. T, rrethana këto të konsoliduara tashmë, jo vetëm me logjiken e ngjarjes, por dhe nga vet shoqëria, si dhe deklarata noteriale e shtetasit A. T.*

*Nuk ka asnjë bazë pretendimi i Komisionit se vlera e paguar duhet të jetë 170.000 euro, pasi siç edhe është sqaruar e risqaruar, shoqëria në mënyrë arbitrare merr një pronë të shitur më parë me 500 euro/m<sup>2</sup> bën fakt të kryer, duke e prishur atë, për t’ia shitur pa asnjë njoftim blerësit të parë një banke me çmim dyfish me të shtrenjtë.*

*Si shtetasi A. T si shoqëria ‘L- EM’ sh.p.k., kanë konfirmuar transaksionin, ashtu siç ka ndodhur nën përgjegjësinë e tyre, fakte reale dhe shprehje e vullnetit të tyre. Këto janë prova të mjaftueshme për të treguar që palët kanë rënë dakord që L. T të paguante 70.000 euro për pasurinë me sip. 179 m<sup>2</sup>, duke zëvendësuar z. A. T në shkëmbimin e pasurive që shoqëria ‘L-EM’ kreu për shkak të shitjes me ‘P.C. B’. Ky është realiteti i konfirmuar nga dy persona, njeri individ e tjetri shoqëri tregtare. Komisioni nuk ka dhënë asnjë provë apo argument, përveç “dyshimeve” se këto deklarata nuk qëndrojnë, apo arsyen përse nuk qëndrojnë.*

*Më tej nuk është e vërtetë që nuk ka prova që L. T ka paguar ndaj z. A.T shumën 70.000 euro”. Subjekti ka shpjeguar se prova që L. T ka paguar shumën prej 70.000 euro është pikërisht deklarata e z. A. T, që është edhe pala e vetme që mund të kishte pretendime për këtë.*

ii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se nga analiza financiare e kryer ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e lokalit nga babai, subjekti ka argumentuar se tej çdo dyshimi babai ka pasur burime të plota blerjeje për shumën e deklaruar prej 70.000 euro dhe më saktë dhe përtej tyre.

*Subjekti ka shpjeguar se: “... referuar edhe testamentit, babai ka lënë vlera të konsiderueshme, 22 monedha, me peshë prej 32.4 gram (që janë pjesë e sasisë së monedhave që ju kam deklaruar gjatë korrespondencës), të cilat siç ju kam bërë prezent se ekzistojnë fizikisht dhe janë bërë prezent dhe në dokumentet zyrtare është e kuptueshme se ka pasur burime mëse të mjaftueshme.*

*Shpjegoj se në vitin 1991 familja, pjesë e së cilës kam qenë deri në vitin 1993, ka pasur 200 monedha ari, që kanë qenë rezultat i të ardhurave, por kryesisht e punës së babait si në shtet, ashtu edhe në banesë. Këto monedha kanë qenë edhe produkt i largpamësisë së babait, i cili*



*në kushtet kur në ato vite nuk mund të shpenzonte aq sa donte apo aq sa kishte mundësi zgjodhi rrugën e konvertimit të parave letër në monedha ari.*

*Në këtë kuptim, në asnjë rast dhe në asnjë arsye babai nuk ka qenë thjesht një pensionist, i cili ka pritur pensionet për t'u ushqyer. Pagesat e pensioneve prej prindërve tërhiqeshin një herë në vit dhe ishin vetëm vlera që ata i administronin sipas interesave e dëshirës së tyre”.*

**Në prapësime, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit administrativ, pa depozituar asnjë dokument provues.**

iii. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se të ardhurat e gjeneruara nga kjo pasuri janë tërhequr prej subjektit nga llogaria e babait, në prapësime, subjekti ka shpjeguar se ky fakt është i vërtetë dhe argumenton se për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të babait në ato vite, ishte në pamundësi shpesh herë për të ndjekur punët e tij.

#### **4.8 Analiza ligjore**

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk provoi pagesa të kryera nga i ndjeri L.T, për blerjen e pasurisë “lokal”.

Referuar kontratës së nënshkruar, ndërmjet palëve kontraktore, e cila është akt ligjor dhe referuar nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ka fuqinë e ligjit për palët. Për pasojë, Komisioni vlerëson se blerësi duhet të ketë paguar për këtë aset çmimin e cituar në kontratë, në shumën 170.050 euro.

Në lidhje me disponimin e monedhave të arit nga familja Tominaj, nuk u provua ekzistenca e tyre.

Fakti se të ardhurat e gjeneruara nga kjo pasuri janë përfituar nga subjekti krijon bindjen se kjo pasuri ishte e tija, përpara se ta përfitonte me testament.

**Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk provoi të ardhurat e ligjshme për krijimin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurisë.**

#### **5. Gjetje të tjera nga Komisioni**

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar një transaksion blerjesh kuotash të “M. P.C” nga nëna e subjektit, znj. F.T, në vlerën 90.000 euro, në vitin 2010. Për këtë fakt, subjektit i është kërkuar që të japë informacion dhe dokumentacion mbi burimin e kësaj shume.

Subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar se<sup>1</sup>: *“Në lidhje me sa më sipër, sqaroj se mbesa ime, me cilësinë e administratorës së firmës ‘T’ për arsyet e saj të biznesit ka hyrë në tratativë për blerjen e firmës tjetër farmaceutike ‘M.P.C’”. Për arsye të strategjisë së biznesit të saj dhe me dëshirën e mirë për të kontribuar në të ardhurat e gjyshes së saj ka iniciuar blerjen në favor të zj. F. T aksionet e shoqërisë në fjalë në shumën 90.000 euro.*

---

<sup>1</sup> Përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. \*\* prot., datë 6.12.2019.

*Shoqëria në fjalë, pas dy vitesh mungesë totale rentabiliteti ka kaluar në fazë likuidimi, pa përfutur asgjë as ime më dhe as mbesa ime, ndërsa shuma prej 90.000 euro ka kaluar nga firma 'T' (Sh P) babai i G te llogaria e saj, kjo e fundit te llogaria e mamasë sime për të përfunduar brenda asaj dite te llogaria e firmës 'M.P.C' çka duket qartësisht dhe nga statementi i bankës në lidhje me këtë fakt, si dhe kontrata e lidhur”.*

Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së kuotave nr. \*\*, datë 11.2.2010, sipas së cilës, blerësja F. T ka blerë 100 % kuotat e kësaj shoqërie.

Nga verifikimi i transaksioneve në llogarinë e znj. F. T në “R. B” duket se shuma prej 90.000 euro është derdhur në llogarinë e kësaj të fundit nga znj. G. P, në datën 12.3.2010. Po në të njëjtën datë, fondet i janë transferuar shtetasit B. F. për blerje kuotash në cilësinë e shitësit, sipas kontratës.

Nga ekstrakti i QKB-së ka rezultuar se znj. F. T ka vazhduar të jetë ortak e vetme e kësaj shoqërie deri më 31.7.2013, kur me vendimin e ortakut të vetëm ka vendosur prishjen e shoqërisë nëpërmjet likuidimit. Aktualisht, kjo shoqëri është në status likuidim e sipër.

**Komisioni ngriti dyshime në lidhje me transaksionin e blerjes së kuotave nga nëna e subjektit. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

### **5.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se burimi i fondeve për blerjen e kuotave është nga znj. G. P. P, e cila është mbesa e znj. F. T (vajza e motrës, znj. E. T.P). Subjekti, ashtu sikurse ka deklaruar gjatë hetimit, sqaron se dokumentet e paraqitura tregojnë qartë kalimin e fondeve në të njëjtën ditë nga znj. G. P. P te znj. F. T dhe nga kjo e fundit te shitësi i kuotave.

Subjekti ka argumentuar se Komisioni nuk ka administruar asnjë dokument që të provojë dhe të argumentojë se ku e bazon kundërshtimin e dokumenteve dhe të provave të paraqitura në lidhje me këtë çështje, por mjaftohet vetëm duke thënë se *shpjegimet nuk janë bindëse për të justifikuar blerjen e kuotave.*

### **5.2 Analiza ligjore**

Nga verifikimi i akteve të administruara në dosje ka rezultuar e provuar se këto shuma kanë kaluar nga mbesa e saj, në llogarinë bankare të znj. F. T (nëna e subjektit) dhe në të njëjtën ditë u derdhën në llogarinë e shitësit të kuotave.

Komisioni, në analizim të provave, arrin në përfundimin se këto transaksione kanë lidhje me veprime të nënës së subjektit me mbesën e saj. Nuk ka *indicie* të mjaftueshme për të menduar se këto transaksione janë kryer për llogari të subjektit të rivlerësimit.

## **6. Shpenzimet për shkollimin e vajzës së subjektit, Ç. T**

Nga hetimi i kryer ka rezultuar se vajza e subjektit ka studiuar në kolegjin “T. O”, në vitet 2004 – 2008, fakt i padeklaruar më parë.

Në lidhje me shpenzimet e shkollimit, subjekti ka shpjeguar<sup>1</sup> se nuk ka ruajtur ndonjë mandatpagese, për shkak të kohës së gjatë, por edhe të faktit se me këtë pjesë merrej babai i tij.

Më tej ka shpjeguar se për shkak të rezultateve të larta, në vitin e parë, është paguar një shumë minimale, e cila më së shumti përfshinte uniformën dhe librat, situatë që vazhdoi edhe në vitet e mëpasme ku rezultatet e çdo viti i mundësuan përfitim e bonuseve të përvitshme.

Komisioni ka kërkuar informacion në kolegjin “T- O”, i cili nuk ka saktësuar shpenzimet e shkollimit për periudhën 2004 – 2008, duke na informuar se nuk disponojnë të dhëna për një periudhë mbi 10 vjet.

Në lidhje me shpenzimet e shkollimit të vajzës në Itali, subjekti ka deklaruar se ka studiuar për 8 vjet dhe ka qenë me bursë të plotë nga shteti italian. Subjekti ka provuar me dokumentacion se vajza e tij ka përfutur bursë të plotë vetëm për 2 vite shkollimi.

**Komisioni ka konstatuar se subjekti ka fshehur shpenzimet e shkollimit të vajzës në Shqipëri dhe në Itali. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.**

### **6.1 Qëndrimi i subjektit**

Në lidhje me shpenzimet e shkollimit në kolegjin “T- O” subjekti ka shpjeguar se ka qenë në praktikën e këtij koleji dhënia e bonuseve për nxënësit me përparim të mirë. Në këtë kuadër ka deklaruar se shpenzimet e shkollimit kanë qenë vetëm në 10-20 % të vlerës. Në këto kushte, për sa kohë kërkohehin shpenzime shkollimi, ato kanë qenë pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të familjes, pasi vlera e tyre ishte mëse minimale.

Subjekti pretendoi se nuk mund të ketë barrën e provës për një provë që nuk ekziston, pasi shteti ka përcaktuar afate për mbajtjen e dokumenteve nga institucionet e aq më tepër individit, i cili nuk ka asnjë detyrim, përveçse personal, për të ruajtur këto dokumente, kur rreth 17 vite më parë nuk mendohej se do të ishte nevojshme për një situatë të tillë.

Subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit në lidhje me shkollimin e vajzës në Itali, duke pretenduar se ka përfutur bursë nga shteti në vlerën rreth 9.100 euro, e cila për kushtet specifike të qëndrimit si e hospitalizuar te familja e shtetases italiane, ishin të mjaftueshme për jetesën deri në fund të vitit 2010. Lidhur me shkollimin për vitet 2008-2009, 2009-2010, 2010-2011 vajza ka shpenzuar paratë e dhëna nga shteti italian.

### **6.2 Analiza ligjore**

Në lidhje me shpenzimet e shkollimit të vajzës në Shqipëri dhe në Itali, Komisioni arsyeton se subjekti kishte detyrimin ligjor që t'i deklaronte këto shpenzime. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk mundi të provojë pretendimet se vajza ishte trajtuar me bursë të plotë në kolegjin “T- O”. Gjithashtu, subjekti provoi se vajza ishte trajtuar me bursë në shtetin italian, vetëm për 2 vite.

## **7. Depozitime në llogaritë në emër të subjektit**

Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti ka kryer disa depozitime të shumave në llogaritë e tij, si vijon:

---

<sup>1</sup> Me përgjigjet e pyetësorit të datës 21.2.2020.

Data e transaksionit	Data e tërheqjes	Shuma	Banka
21.6.2007	23.7.2007	9.500 eur	Credins Bank
23.7.2009	23.10.2009	10.000 eur	Raiffeisen Bank

Subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar, ndër të tjera, se: “...këto shuma kanë qenë kursime të familjes që janë depozituar në bankë për qëllim përfitim interesi”.

**Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi për të pasur cash shumat e depozituara në bankë prej 9.500 euro, në datën 21.6.2007 dhe 10.000 euro në datën 23.7.2009.**

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

### **7.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti ka shpjeguar se këto shuma kanë qenë kursime të familjes që janë depozituar në bankë për të përfituar interesa.

### **7.2 Analiza ligjore**

Komisioni arsyeton se subjekti kishte detyrimin ligjor të provonte burimin e ligjshëm për likuiditetet e depozituara në “C. B” dhe në “R. B”.

**Trupi gjykues, për faktin se subjekti nuk provoi bindshëm të ardhurat e ligjshme për krijimin e tyre, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë.**

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se z. Blerim Tominaj:

- i. Nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, të parashikuara në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Blerim Tominaj.
2. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.6.2020.

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**  
**Relatore**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*